



# KRITERET E PËRGJITHSHME TË PJESËMARRJES SË FËMIJËVE



**Save the Children**  
100 YEARS



**Suedi**  
**Sverige**

**UDHËZUES DHE INSTRUMENTE SEKTORIALË PËR REALIZIMIN  
E NJË PJESËMARRJEJE KUPTIMPLOTTË TË FËMIJËVE**



**Save the Children**  
100 YEARS



# KRITERET E PËRGJITHSHME TË PJESËMARRJES SË FËMIJËVE

**UDHËZUES DHE INSTRUMENTE SEKTORIALË PËR REALIZIMIN E NJË PJESËMARRJEJE**

**KUPTIM PLOTË TË FËMIJËVE**

*Tiranë, 2018*

## **“KRITERET E PËRGJITHSHME TË PJESËMARRJES SË FËMIJËVE”**

### **Autor:**

Suela Bala, Ekspert

### **Grupi i punës në Save the Children**

Blerina Çeloaliaj- Drejtore Programi

Edlira Ngjeci- Manaxhere Programi

Sabina Çarçani - Specialiste Tematike

Iva Korumi – Oficere Programi

### **Tiranë, 2018**

Save the Children është organizatë kryesuese në botë dhe e pavarur për fëmijë. Ne besojmë së çdo fëmijë meriton një të ardhme të mirë. Në botë dhe në Shqipëri, Ne ndihmojmë fëmijët të kenë një fillim të mbarë në jetë, mundësi për të mësuar dhe mbrojtje ndaj çdo rreziku. Ne bëjmë më të mirën për fëmijët - çdo ditë dhe në kohë krize –për të sjellë ndryshime në jetën e tyre dhe të ardhmen e përbashkët.

Ky udhëzues publikohet në kuadër të projektit “Nga Fëmijët për Fëmijët”, i financuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar dhe zbatuar nga Save the Children në bashkëpunim me Zyrën e Avokatit të Popullit dhe Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

@Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej specialistëve të fushës, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim të shoqërohet me njohjen e organizatave, të përmendura më lart, si burim.

Këndvështrimet e autorëve të këtij botimi jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Save the Children.

## FALENDERIME

Mirënjohje e veçantë dhe një falenderim i madh për të gjithë fëmijët që kanë marrë pjesë në grupet e konsultimit, të cilët kanë qënë pjesë e grupimit “Zëri 16+...” në Burrel dhe Elbasan. Ata kanë ndarë mendimet, përvojat, ndjesitë dhe sugjerimet e tyre rreth pjesëmarrjes së fëmijëve në Shqipëri.

Gjithashtu, shprehim falenderim, drejtuar gjithë përfaqësuesve të shoqërisë civile që i kushtuan kohë dhe u bënë pjesë e intervistave të drejtpërdrejta si pjesë e punës në terren për përgatitjen e këtij udhëzuesi. Të gjithë përfaqësuesit e shoqërisë civile ndanë me grupin e punës, mendime mbi pjesëmarrjen e fëmijëve në Shqipëri si dhe mbi çështjet të cilat janë pjesë e këtij dokumenti.

Falenderojmë në mënyrë të veçantë Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës për kontributin e dhënë në hartimin e këtij udhëzuesi.

Falenderime të sinqerta dhe mirënjohje e thellë për Agjencinë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar që përmes mbështetjes bëri të mundur hartimin e “Kritereve të Përgjithshme të Pjesëmarrjes së Fëmijëve” .

**Grupi i Punës në Save the Children**



## FJALË HYRËSE NGA SAVE THE CHILDREN

Pjesëmarrja e fëmijëve është një nga të drejtat themelore, e mëshiruar në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës dhe që duhet garantuar nga të gjitha institucionet përgjegjëse si dhe nga shoqëria.

Përmes hartimit të këtij udhëzuesi ne synojmë të promovojmë, inkurajojmë dhe lehtësojmë pjesëmarrjen kuptimplotë dhe gjithëpërfshirëse të fëmijëve si dhe të garantojmë që zëri i tyre të dëgjohet dhe përfshihet në vendimarrje në të gjitha nivelet si

në familje, shkollë, komunitet, bashki dhe qeveri.

Hartimi i këtij udhëzuesi dhe instrumenteve sektoriale për realizimin e një pjesëmarrjeje kuptimplotë të fëmijëve janë rezultat i një procesi të gjërë konsultimesh me fëmijët e grupeve “Zëri 16+” në qytetin e Elbasanit, Durrësit, Burrelit dhe Peshkopisë si edhe stafit të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

Mendimet dhe kontributi i fëmijëve, të reflektuar në këtë udhëzim, sigurojnë informacion të rëndësishëm dhe ndihmojnë profesionistët në punën e tyre të drejtëpërdrejtë me fëmijët dhe iu shërbejnë autoriteteve dhe vendimarrësëve të hartojnë politika dhe praktika që ndikojnë në përmirësimin e situatës dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve.

Për të nxitur pjesëmarrjen e fëmijëve, ne gjithashtu duhet të ndikojmë drejtpërdrejtë tek njohuritë, aftësitë dhe kapacitetet e fëmijëve dhe të rinjve për të njohur, edukuar dhe praktikuar të drejtën e pjesëmarrjes në vendimet që ndikojnë jetën e tyre dhe të bashkëmoshatarëve të tyre.

Pas rreth 19 vitesh bashkëpunimi të ngushtë me grupet e fëmijëve, ne konstantojmë me kënaqësi se fëmijët dhe të rinjtë me të cilët kemi punuar dhe janë angazhuar aktivisht, sot ata janë qytetarë të informuar dhe të përgjegjshëm të këtij vendi si dhe janë bërë avokatë të denjë të fëmijëve dhe vecanarisht të grupeve të fëmijëve, të cilët nuk kanë një zë të fortë dhe ende përjashtohen dhe diskriminohen.

Dëgjimi i zërit të fëmijëve dhe pjesëmarrja e tyre kuptimplotë mbeten jetike në zhvillimin pozitiv të fëmijëve si individë dhe për shoqërinë në nivel afatgjatë. Garantimi i kësaj të drejte do të krijonte një mirëqenie më të mirë për fëmijët dhe një ambient më të denjë dhe miqësor për ta.

**Anila Meço**

Drejtoreshë

Save the Children

## FJALË HYRËSE NGA AGJENCIA SHETËRORE PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS

Fëmijët janë e tashmja dhe ardhmja e një shoqërie. Pjesëmarrja dhe dëgjimi i zërit të fëmijëve, është një e drejtë themelore dhe ka rëndësi të madhe në jetën sociale të një vendi. Kjo qasje përgatit fëmijët për të qenë qytetarë të denjë dhe të përgjegjshëm, i mundëson mbrojtjen e të drejtave të tyre, përmirëson shërbimet e fëmijëve, nxit politika më të mira mbrojtjeje, nxit praktika me parime demokratike, fuqizon fëmijët të rriten të përgjegjshëm dhe të përmbushin detyrimet ligjore.



Fëmijët kanë të drejtë të përfshihen në gamën e gjerë të çështjeve që i prekin ata. Ndërsa rriten dhe zhvillojnë mundësitë e tyre për pjesëmarrje, duhet të zgjerohet edhe hapësira e tyre në ndikimin e jetës së komunitetit ku jetojnë.

Ndonëse disa fëmijë kanë filluar të ushtrojnë në mënyrë aktive të drejtën e tyre për pjesëmarrje, dhe nëpërmjet zërit të tyre kanë filluar të bëhen agjentë të ndryshimit, zërat e shumë fëmijëve të tjerë mbeten të padëgjuar, interesat e tyre mbeten të harruara ose të injoruar.

Edhe pse pjesëmarrja e fëmijëve është një koncept i ri për shoqërinë tonë, në vitet e fundit, vëmendja e politikës dhe institucioneve është rritur ndjeshëm në vlerësimin dhe respektimin e mendimit të fëmijëve.

Tashmë pjesëmarrja e fëmijëve është një realitet konkret, që është përfshirë edhe në angazhimin e institucioneve shtetërore gjatë proceseve për hartimin e ligjeve e politikave të reja për çështjet e të drejtave të fëmijëve. Ata janë konsultuar gjatë hartimit të Ligjit “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” si dhe Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës 2017-2020.

Dëgjimi i fëmijëve dhe lejimi i tyre për të kontribuar në këto procese, çojnë në vendime më të mira, në politika që janë në të vërtetë, jo vetëm teorikisht, në interes të fëmijëve. Gjithashtu, i ofron fëmijëve një mundësi për vendim-marrje demokratike dhe të mësojnë për të drejtat dhe fuqitë e tyre si qytetarë, me përfitime afatgjata për shoqërinë në tërësi.

Udhëzuesi që po paraqesim synon të informojë profesionistët mbi larminë e mekanizmave efektivë për të siguruar pjesëmarrjen kuptimplotë të fëmijëve, pavarësisht llojit të aktivitetit ku ata do të përfshihen. Udhëzuesi është një dokument, por mbi të gjitha theksoj se duhet të shihet si një mjet pune për çdo profesionist që punon me fëmijët apo për fëmijët, në institucione shtetërore qendrore e vendore, apo organizata, shkolla etj.

**Alma Tandili**

Kryetare

Agjencia Shtetërore për të Drejtat  
dhe Mbrojtjen e Fëmijës

## PËRMBAJTJA

I. Hyrje.....	11
II. Çfarë është pjesëmarrja e fëmijëve?.....	14
III. Pse është e rëndësishme pjesëmarrja e fëmijëve? .....	17
IV. Parimet etike .....	18
V. Mbrojtja e sigurisë së fëmijëve në proceset pjesëmarrëse .....	21
VI. Kriteret e përgjithshme të pjesëmarrjes së fëmijëve.....	23
VII. Listë kontrolluese për mbarëvajtjen e procesit .....	33
VIII. Lehtësimi i procesit .....	35
IX. Përfshirja e fëmijëve – përfaqëse sektoriale .....	36
• Shërbime Shoqërore .....	36
• Arsim.....	37
• Shëndetësi .....	37
• Drejtësia për të mitur .....	38
• Pushteti Vendor:.....	39
X. Grupet e konsultimit të fëmijëve/ praktika të mira .....	40
Shtojca nr. 1 – Politika e mbrojtjes së fëmijëve .....	44
Shtojca nr. 2- Format marrje pëlqimi për pjesëmarrje .....	48
Shtojca nr. 3 - Model planifikimi.....	51
Shtojca nr. 4- Model ushtrime energjizuese .....	52
Bibliografia.....	54

## I. HYRJJE

Pjesëmarrja është një nga parimet bazë të Konventës së të Drejtave të Fëmijëve e cila artikullohet me anë të **Nenit 12**, që përcakton qartazi se fëmijët gëzojnë të drejtën e pjesëmarrjes në proceset vendim-marrëse që ndikojnë jetën e tyre. Ky nen, u njeh të drejtën fëmijëve të influencojnë vendime që kanë të bëjnë me familjen, shkollën, komunitetin ku ata bëjnë pjesë dhe çdo gjë tjetër që ndikon drejtpërdrejtë në jetën e tyre. Parimi njeh aftësinë e fëmijëve për të qënë pjesëmarrës të vlefshëm në proceset vendim-marrëse, për të dhënë mendime dhe sugjerime në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me jetët e tyre në përshtatshmëri me moshën dhe pjekurinë.

Si e tillë pjesëmarrja e fëmijëve pasuron proceset demokratike dhe garanton rritjen dhe formimin e gjeneratave të ardhshme të qytetarëve të ndërgjegjshëm dhe aktivë në jetët e komuniteteve të tyre.

Si një e drejtë thelbësore, e drejta për pjesëmarrje kërkon përfshirjen dhe angazhimin e të rriturve si individë apo/ edhe si insitucione qeveritare, publike dhe jopublike, organizata, dhe grupime komunitare puna e të cilëve ndikon drejtpërdrejtë apo tërthorazi në jetën e fëmijëve. Kjo e drejtë realizohet në bazë të një procesi dialogu dhe shkëmbimi të lirë mendimesh gjatë të cilit fëmijët shprehin mendime dhe marrin përgjegjësi.

Fëmijët dhe të rinjtë e përfshirë në procese pjesëmarrjeje, përbëjnë një burim të jashtëzakonshëm njohurish dhe këndvështrimesh, por shpeshherë të pakuptueshme nga të rriturit. Ata shpeshherë njohin dhe artikulojnë më mirë së të rriturit problematikat dhe sfidat e bashkëmoshatarëve të tyre të marginalizuar dhe jo vetëm.

Kur fëmijët dhe të rinjtë ndihen të respektuar, të dëgjuar dhe të konsideruar nga të tjerët ata rrisin vetëvlerësimin dhe janë në gjendje të fitojnë më shumë kontroll mbi jetët e tyre duke u shndërruar në qytetarë të ndërgjegjshëm dhe aktivë që punojnë dhe ndikojnë pozitivisht jetën e komuniteteve ku ata jetojnë.

Në vitin 2017 Kuvendi i Shqipërisë miratoi **Ligjin Nr.18/2017, për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës**, i cili përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës, në zbatim të Kushtetutës, të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës, të akteve Ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë, si dhe të legjislacionit në fuqi duke garantuar mirëqenien e fëmijës, duke promovuar e mundësuar zhvillimin e tyre në shoqëri, duke i siguruar fëmijës ushtrimin e të drejtave, në përputhje me zhvillimin e personalitetin, bazuar në interesin më të lartë të tij. Ky ligj ka në themel të tij parimin e pjesëmarrjes së fëmijës dhe e përkufizon atë si një proces të vazhdueshëm të përfshirjes aktive të fëmijës dhe të respektimit të së drejtës së tij për t'u shprehur e për t'u dëgjuar në të gjitha nivelet e vendim-marrjes për çështje që lidhen me të. **Neni 12** i këtij ligji sanksionon lirinë e shprehjes së fëmijës.

Fëmija ka të drejtë të shprehë lirisht, individualisht dhe kolektivisht pikëpamjet dhe mendimin e tij për çdo çështje që ka të bëjë me të drejtpërsëdrejti osë me familjen e tij apo komunitetin, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. Fëmija ka të drejtë të kërkojë, të marrë dhe



të përcjellë informacion e ide të çdo lloji, në çdo formë osë me çdo mjet të zgjedhur nga ai, me përjashtim të rasteve kur çënohet një interes publik, siguria kombëtare ose nderi e dinjiteti apo të drejtat e të tjerëve.

**Neni 13** garanton të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar vetë osë nëpërmjet prindit, kujdestarit, ose përfaqësuesit jo vetëm në të gjitha proceset administrative e gjyqësore që lidhen me të, por edhe nga autoritetet shtetërore gjatë proceseve vendim-marrëse që lidhen me hartimin e zbatimin e politikave për të drejtat e fëmijës dhe mbrojtjen e tyre. Sipas këtij neni, fëmija, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar, ka të drejtë të ankohet vetë osë nëpërmjet prindit, kujdestarit, ose përfaqësuesit të tij kundër vendimeve apo masave të marra nga autoritetet shtetërore lidhur me të, sipas legjislacionit në fuqi dhe detyron punonjësit e administratës së shërbimit civil osë të administratës gjyqësore t'i japin këshillimin e nevojshëm. Ligji garanton të drejtën e fëmijës për informim në lidhje me mirëqënien, edukimin dhe zhvillimin e tij fizik e psikologjik, si dhe aksesin në të gjithë regjistrat ku mbahen të dhëna për të.

## QËLLIMI, OBJEKTIVAT DHE PËRDORIMI I KËTJË UDHËZUESI

*“Ka vendime për të cilat nuk vendosim në fëmijët, por në rastet kur ka vendime të vogla, pyetemi edhe ne” – E.Xh. Katund i Ri*

*“Edhe ata që bëjnë konsultime duhet të jenë pak më të përshtatshëm, pak më të qartë me fëmijët. Duhet të dinë se si ta bëjnë bashkëbisedimin, t'i shtyjnë fëmijët që të japin ide sa më të shumta, pa pasur frikë” – K.C Burrel*

Pavarësisht përpjekjeve që promovojnë konsultimin e fëmijëve mbi çështje të ndryshme që lidhen më të përditshmen dhe të ardhmen e tyre, përfshirja në vendim-marrje mbetet e kufizuar për shumë arsye, përfshirë vullnetin dhe kapacitetin e të rriturve për të besuar dhe marrë në konsideratë këndvështrimin e fëmijës. Mungesa e mekanizmave sektoriale është një tjetër arsye, përveç sektorit të arsimit që ka parashikuar ngritur dhe vënë në funksionim Qeveritë e Nxënësve apo Bordet e Shkollave të cilat përbëjnë mekanizma konkretë për të vënë në zbatim parimet e parashikuara në Ligj. Ky dokument synon të paraqesë një përmbledhje të mënyrës se si organizohen proceset pjesëmarrëse në varësi nga qëllimi i tyre, kush dhe si e organizon, lehtëson dhe administron procesin si dhe instrumentat praktike për përfshirjen e fëmijëve. Si i tillë do të jetë një ndihmesë e vlefshme për secilin nga profesionistët që angazhohet në sigurimin e pjesëmarrjes së fëmijëve.

Qëllimi i këtij publikimi është të inkurajojë dhe të lehtësojë pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve, në proceset konsultuese dhe vendimarrëse në të gjitha nivelet. Ai bazohet në Kriteret Bazë të Kombeve të Bashkuara si dhe në Komentin e Përgjithshëm Nr. 12 mbi Pjesëmarrjen Kuptimplotë të Fëmijëve, dhe ofron udhëzon të rriturit në promovimin dhe përmbushjen e së drejtës së fëmijëve për pjesëmarrje dhe të drejtave të fëmijëve në tërësi si pjesë e aktiviteteve, projekteve, programeve, politikave apo shërbimeve për fëmijët duke u prezantuar atyre parimet kryesore të pjesëmarrjes shoqëruar me një menu indikatorësh matës për secilin. Në fund prezantohet një listë pyetjesh për të shërbyer si listë kontrolli për mbarëvajtjen e procesit.

Udhëzuesi synon gjithashtu t'i vijë në ndihmë një audience të gjerë që përfshin si individë/ profesionistë pa përvojë në punën me fëmijët ashtu edhe individë/ profesionistë me një përvojë të gjerë, punonjës të agjencive dhe institucioneve shtetërore, punonjës për mbrojtjen e fëmijës, punonjës të njërive të qeverisjes vendore, institucioneve arsimore, institucioneve të përkujdesjes sociale, njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve, organizatave jofitimpruresë, grupimeve/organizatave të fëmijëve dhe të rinjve, grupimeve qytetare, organizatave të shoqërisë civile etj.

Në të pasqyrohen disa kritere të praktikës të pranueshme si nga të rriturit dhe fëmijët të cilat do të sigurojnë që proceset ku do të përfshihen fëmijët të jenë të një cilësie të lartë, ku të respektohen parimet etike të pjesëmarrjes dhe t'u ofrojnë një mundësi reale fëmijëve të shprehin opinionin e tyre dhe të influencojnë vendim-marrjen, por dhe të rrisin e të zhvillojnë potencialet e tyre nëpërmjet proceseve fuqizuese.

Ndaj nëse do shihnim edhe fushat kryesore të aplikimit të parimit të pjesëmarrjes, ato do të fillonin që në nivel individual e familjar, në komunitet, në shkollë, në shërbimet që merren nga fëmijët në një situatë të vështirë, në shëndetësi, në procese gjyqësore, në institucionet vendim-marrëse lokale apo qendrore si dhe nga instrumentet kombëtarë dhe ndërkombëtare të monitorimit dhe garantimit të të drejtave të fëmijëve.

### **Udhëzuesi synon të:**

- Zbërthejë në praktikë dhe të sjellë një të kuptuar të përbashkët të parimit të pjesëmarrjes së fëmijëve dhe si mund të realizohet ajo.
- Ndihmojë në strukturimin dhe standardizimin e procesit dhe rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe të rinjve në vendim-marrje dhe politikbërje.
- Mbështesë institucionet shtetërore, njësitë e qeverisjes vendore, institucionet arsimore, institucionet e përkujdesjes sociale, organizatat jofitim-prurëse, grupimet/organizatat e fëmijëve dhe të rinjve, grupimet qytetare, organizatat e shoqërisë civile në realizimin e konsultimeve dhe aktiviteteve pjesëmarrëse me fëmijët dhe të rinjtë.
- Sigurojë konsistencë dhe cilësi në proceset pjesëmarrëse dhe konsultative me fëmijët dhe të rinjtë duke marrë parasysh edhe diversitetin e grupeve.
- Synon të ofrojë instrumente praktike për të garantuar një proces pjesëmarrjeje të mirëfilltë e kuptimplotë që respekton të gjitha parimet etike të punës me fëmijët.
- Synon të ofrojë shembuj praktikë se si të zbatohet parimi i Pjesëmarrjes së Fëmijëve në disa fusha specifike ku fëmijët janë subjekt i strategjive, planeve të veprimit apo shërbimeve të ofruara nga sektorë të ndryshëm si Arsimi, Shërbimet e Mbrojtjes Shoqërore, Shëndetësia, Vendimarrja Lokale dhe Qendrore por edhe në ushtrimin e rolit të tyre si Monitorues dhe Raportues së Situatës së të Drejtave të Fëmijëve në vend.

Ai është hartuar në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, si një detyrim i parashikuar dhe në Agjendën Kombëtare për Fëmijët 2017 – 2020. Ai reflekton medimet e dala nga një konsultim i gjerë me grupet e fëmijëve të përfshirë në projektet e Save the Children, aktorë të shoqërisë civile në Shqipëri si dhe përvojën më të mirë ndërkombëtare.

## II. ÇFARË ËSHTË Pjesëmarrja e fëmijëve?

### Neni 12-të i Konventës së të Drejtave të Fëmijëve përcakton se:

“Shtetet Palë i garantojnë fëmijës, i cili është i aftë të ketë pikëpamjet e tij, të drejtën për t’i shprehur lirisht këto pikëpamje, për çdo çështje që ka të bëjë me të, duke i vlerësuar ato në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tij.”

Pjesëmarrja e fëmijëve do të thotë që fëmijët kanë të drejtë të dëgohen, të shprehin mendimin dhe të influencojnë vendimet që i prekin drejtëpërdrejtë.

Pjesëmarrja është ndër parimet themelore të **Konventës së të Drejtave të Fëmijëve** miratuar nga **Organizata e Kombeve të Bashkuara në vitin 1989** dhe **ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1992**.

Nenet e tjera që lidhen me pjesëmarrjen e fëmijëve përfshijnë **Nenin 13** që njuh të drejtën e fëmijës për të kërkuar, marrë dhe dhënë informacion dhe mendim të çfarëdo lloji dhe **Nenet 14, 15, 16, 17**, të cilat sigurojnë të drejtën e fëmijës për lirinë e shprehjes, mendimit, ndërgjegjes, besimit fetar, grumbullimit paqësor, mbrojtjes së privatësisë dhe aksesin në informacion dhe **Nenin 23** që u jep fëmijëve me aftësi të kufizuar të drejtën për pjesëmarrje në komunitet dhe **Neni 2** që sanksionon zbatimin e gjithë çfarë parashtrohet në konventë për çdo fëmijë.

Bazuar në sa më sipër, pjesëmarrja përkufizohet si një proces i vazhdueshëm i të shprehurit dhe i përfshirjes aktive të fëmijëve në të gjitha nivelet e vendim-marrjes në çështje që i prekin drejtëpërsëdrejti ata.

Procesi i pjesëmarrjes kërkon, komunikim, ndarje të vazhdueshme dhe të plotë informacioni, dialog të vazhdueshëm ndërmjet fëmijëve dhe të rriturve si edhe bazohet në respektin ndaj opinionit dhe pikëpamjeve të fëmijëve dhe aftësisë së tyre për t’u shprehur bazuar në moshë, pjekuri, kontekst socio- ekonomik dhe aftësi.

Pjesëmarrja është e lidhur ngushtë me njerëzit që ndajnë ide mes tyre mendojnë për vete, shprehin opinione në mënyrë efektive, planifikojnë, priorizojnë dhe marrin pjesë në vendim-marrje për të bërë ndryshim. Pjesëmarrja e fëmijëve do të thotë fuqizim i tyre për të qenë pjesë aktive e vendim-marrjes dhe arrihet duke i dhënë mundësinë atyre të kenë akses të vendimarrësit dhe informacioni i duhur, mbështetje nga të rriturit tek të cilët ata kanë besim, mundësinë për t’u përfaqësuar si edhe mekanizmat e ankimit në rast nevojë.

- a) **Neni 5. “Shtetet Palë respektojnë përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrat që kanë prindërit osë, sipas rastit, anëtarët e familjes së zgjeruar osë të bashkësisë, siç parashikohet nga zakoni i vendit, kujdestarët osë përsona të tjerë ligjërisht përgjegjës për fëmijën, për t’i dhënë këtij, në përputhje me zhvillimin e aftësive të tij, drejtimin dhe udhëheqjen e duhur për ushtrimin e të drejtave që i njeh atij kjo Konventë.”**
- b) **Neni 13. “Fëmija ka të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë për të kërkuar, për të marrë dhe për të përcjellë informacione dhe ide të çdo lloji, pa marrë parasysh kufijtë, në formë verbale, të shkruar, të shtypur ose artistike, ose me çdo mjet tjetër të zgjedhur nga fëmija.”**

**Pjesëmarrja konsultative** ndodh kur të rriturit kanë nevojë të mbledhin informacion nga fëmijët që do t’u shërbejë nismave për të përmirësuar ose/dhe hartuar legjislacione, politika apo shërbime që prekin direkt fëmijët. Nismëtarët, drejtuesit dhe menaxhuesit e këtij procesi pjesëmarrjeje janë të rriturit.

**Pjesëmarrja bashkëpunuese** haset në rastet kur synimi është forcimi i proceseve demokratike, krijimi i mundësive për fëmijët për të kuptuar dhe zbatuar parimet e demokracisë apo/ edhe përfshirja e fëmijëve në zhvillimin e hartimin e legjislacionit, politikave dhe shërbimeve që ndikojnë drejtpërdrejtë në jetën dhe mirëqënien e tyre. Pjesëmarrja bashkëpunuese, në varësi të kontekstit mund të ketë për nismëtare si fëmijët ashtu dhe të rriturit. Partneriteti fëmijë- të rritur, është faktor kyç dhe ndikon në fuqizimin e fëmijëve për të influencuar dhe sfiduar si procesin e ndjekur ashtu dhe rezultatin e arritur.

**Pjesëmarrja e drejtuar/ menaxhuar/ iniciuar nga vetë fëmijët** ndodh në rastet kur qëllimi është fuqizimi i fëmijëve për të marrë nisma që identifikojnë çështjet shqetësuese për ta, t’i shpalosin lirshëm këto shqetësime dhe kërkojnë marrjen e masave për zgjidhjen e tyre. Të rriturit në këto raste shërbejnë si lehtësues të procesit dhe në asnjë rast nuk ndërhyjnë për t’a drejtuar atë. Drejtimi dhe kontrolli i procesit kryhet nga vetë fëmijët.

## **Si realizohet konsultimi? Cilët fëmijë marrin pjesë?**

Në disa raste si psh: në krijimin e grupeve të konsultimit për qëllim planifikimi, apo monitorimi, si edhe marrje mendimi mbi çështje të caktuara, aktiviteti targeton një grup më të vogël fëmijësh. Po cilët do të jenë fëmijët që do marrin pjesë në këtë grup dhe si duhen zgjedhur ata, që grupi të jetë vërtetë përfaqësues? Për sa të jetë e mundur në varësi të rrethanave të aktivitetit, do duhet të jenë vetë fëmijët ata që do të zgjedhin përfaqësuesit e tyre. Si në çdo proces tjetër demokratik, edhe në këtë rast, fëmijët e zgjedhur do të duhet të përfaqësojnë të njëjtat interesa, të shprehen në emër të një grupi më të madh fëmijësh dhe të raportojnë/ informojnë grupin që i ka zgjedhur mbi procesin dhe arritjet.

Hapat paraprakë:

- *Informohen fëmijët në lidhje me procesin.*
- *Ndërtohet një proces i drejtë dhe transparent me kritere të qarta në përzgjedhjen e fëmijëve që do marrin pjesë në konsultim.*
- *Hartohet plani i konsultimit/ takimit me fëmijët.*

Procesi i përzgjedhjes duhet të targetojë:

- *Fëmijë me një interes direkt, që kanë një ekspertizë apo njohuri mbi çështjen objekt i konsultimit.*
- *Fëmijët që përzgjidhen duhet të përfaqësojnë një grup të gjerë fëmijësh.*

## **Përzgjedhja e fëmijëve – Kriteret e përzgjedhjes duhet të konsiderojnë sa më poshtë:**

- *Gjinia*
- *Mosha e fëmijës (më të vegjël, më të rritur)*
- *Fëmijë me aftësi të kufizuar*
- *Vendbanimi në fshat apo qytet, të sigurohet një ekuilibër në përfaqësimin e zonave/ rajoneve*
- *Shkojnë apo nuk shkojnë në shkollë*
- *Aspekte sociale dhe ekonomike*
- *Përkatësi etnike*
- *Besimi fetar*

### III. PSE ËSHTË E RËNDËSISHME Pjesëmarrja e fëmijëve?

**Konventa e të Drejtave të Fëmijëve** në nene të veçanta të saj, njih qartësisht fëmijët si qytetarë të barabartë aktivë dhe aktorë social të rëndësishëm, mendimet dhe nevojat e të cilëve duhen konsideruar seriozisht. Vetë fëmijët janë njohësit më të mirë të jetës së tyre në të gjitha aspektët dhe dimensionet pavarësisht se ata duhet të jenë në mbrojtjen dhe mbështetjen e vazhdueshme të të rriturve. Mbështetja që të rriturit duhet t'i japin fëmijëve për të qenë pozitive duhet të jetë me fokus të fëmija dhe të jetë pjesëmarrësë.

Ligji Nr. 18/2017 “PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS” neni 5 pika 10, përcakton se pjesëmarrja, dëgjimi dhe respektimi i mendimit të fëmijës, duhet bërë në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.

Pjesëmarrja lidhet me mundësitë që u krijohen fëmijëve për të shprehur këndvështrimin e tyre, të influencojnë në vendim-

marrje dhe të sjellin një ndryshim. Pjesëmarrja është përfshirja e informuar dhe e vullnetshme e të gjithë fëmijëve, përfshirë edhe ata fëmijë më pak të favorizuar apo që janë të përjashtuar nga zhvillimet sociale, fëmijë të moshave, gjinive dhe aftësive të ndryshme, në çdo çështje që ata i prek drejtëpërsëdrejti apo tërthorazi. Pjesëmarrja është një metodë punë dhe parim i rëndësishëm që prek shumë fusha të jetës: familje, komunitet, shkolla, institucione lokale, qendrore e deri në ato ndërkombëtare.

Në mënyrë që pjesëmarrja të jetë efektive, etike dhe e sigurt, është e domosdoshme që të vendosen e të aplikohen disa parime dhe standarde të cilat do të bejnë të mundur që fëmijët të mos manipulohen, të vendosen në rrezik apo t'u mohohet mundësia për të shprehur mendimet e tyre.

#### ***Pjesëmarrja e fëmijëve është e rëndësishme pasi ajo:***

- Kontribuon në zhvillimin personal, fuqizimin dhe motivimin e tyre.
- Forcon ndërgjegjësimin e tyre rreth të drejtave duke zhvilluar aftësitë mbrojtëse dhe advokuese.
- Promovon aftësitë e fëmijëve për përfshirje dhe angazhim civil, tolerancë, respekt për të tjerët sidomos më të marginalizuarit.
- Zhvillon dhe përmirëson shërbimet e synuara dhe të domosdoshme
- Ofron një perspektivë afatgjatë rreth çështjeve të së ardhmes të vështira për t'u perceptuar nga brezi i vjetër.

Praktikat më të mira ndërkombëtare por edhe ato shqiptare e kategorizojnë pjesëmarrjen e fëmijëve në tre nivele; ***konsultim, bashkëpunim dhe pjesëmarrje e drejtuar/ menaxhuar nga vetë fëmijët.*** Përzgjedhja e gjithësecilit nivel varet nga konteksti, koha dhe mundësitë e fëmijëve për t'u angazhuar.

## IV. PARIMET ETIKE

Ka disa parime etike të cilat duhet të sigurohen çdo herë kur fëmijët përfshihen në procese si: mbledhje të dhënash, pjesëmarrje në studime, konsultime mbi dokumentë strategjike apo aktivitete të tjera me pjesëmarrje. Dy janë parimet thelbësore: “interesi me i lartë i fëmijës” dhe “mos dëmtimi.” Këto dy parime do të përcaktojnë nëse fëmijët duhet të marrin pjesë apo jo dhe kur duhet të përfshihen në këto procese. Interesi më i lartë i fëmijës si konsiderata parësore aplikohet duke promovuar dhe mbrojtur mirëqenien e fëmijës, nga ana tjetër duhet të sigurojme që asnjë hallke e procesit ku përfshihen fëmijët nuk do të shkaktojë dëm të çdo lloji tek ta. Disa konsiderata të tjera që garantojnë procese me standarde të larta etike janë:

### **(1) Vlerësimi i rreziqeve dhe marrja e masave për shmangien e tyre**

Përpara një aktiviteti me pjesëmarrje të fëmijëve duhet kryer vlerësimi i rreziqeve që mund të paraqesë aktiviteti dhe një plan masash për minimizimin e tyre. Duhet marrë në konsideratë një gamë e gjerë rreziqesh të menjëhershme apo afatgjata, duke vlerësuar edhe qëndrimin apo aprovimin e prindërve/ kujdestarëve si dhe përfaqësuesve lokalë në lidhje me angazhimin e fëmijëve në një aktivitet advokues apo konsultues. Kjo pasi në disa raste mund të jetë e papërshtatshme (në aspektin etik) të marrësh të dhëna nga fëmijët, psh nëse personi që mbledh të dhënat nuk ka aftësitë e duhura të intervistimit me fëmijët, nëse çështja në fjalë nuk është në përputhje me moshën e tyre, apo nëse mbështetje e metejshme mund të mos u ofrohet fëmijëve të angazhuar.

### **(2) Sigurojmë që stafi është i kualifikuar dhe me figurë të pastër morale**

Institucionet që përfshijnë fëmijë në aktivitete apo që kërkojnë të mbledhin të dhëna përmes konsultimit me fëmijët, kanë detyrimin etik të angazhojnë në këto procese staf që ofron siguri, profesional, që ka marrë trajnimet dhe mbështetjen e nevojshme për të kryer këtë detyrë. Kjo pasi gjatë proceseve konsultuese apo angazhuese të fëmijëve mund të vihen në kontakt me të dhëna sensitive, me situata vulnerabiliteti etj, të cilat kanë nevojë të menaxhohen siç duhet dhe mund të krijojnë pasoja si në proces ashtu dhe në mirëqenien e fëmijëve të angazhuar. Njohuritë dhe përvoja në fushën e mbrojtjes së fëmijëve do duhet të jetë një kriter si dhe aftësi në teknikat e intervistimit apo lehtësimit të aktiviteteve me fëmijët. Stafet e angazhuara duhet të trajnohen në qasje miqësore me fëmijët, në vlerësimin e maturisë së fëmijëve, aplikimin e parimeve të barazisë gjinore dhe gjithëpërfshirjes, si dhe të kuptojnë zhvillimin fizik dhe mendor të fëmijëve sipas fazave të zhvillimit dhe në evidentimin e shenjave të stresit/vështirësive.

### **(3) Të garantojmë Pranimin dhe Dakordësimin**

Pranimi i informuar i fëmijëve apo dakordësimi i informuar i prindërve apo kujdestarëve për përfshirjen e fëmijëve në një aktivitet apo në konsultime dhe intervistime do duhet të bëhet përpara se të nisë procesi i pjesëmarrjes së fëmijëve. Nëse fëmijët vendosin të marrin apo mos marrin pjesë në një aktivitet ky vendim do duhet të vijë pas një informimi të kujdesshëm, ku fëmijët të kuptojnë siç duhet arsyen e angazhimit të tyre, rolin, si edhe çfarë pritet prej tyre. Kjo e shoqëruar dhe me një shpjegim të hapave të mëtejshëm – çfarë pritet të ndodhë më pas?

#### ***(4) Garantimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave***

Është thelbësore të kuptohet dhe të aplikohet mbrojtja e identitetit dhe të dhënave të fëmijëve. Profesionistët e angazhuar në veprimtaritë me fëmijët apo që mbledhin të dhëna nga fëmijët nëpërmjet konsultimeve, duhet të kenë në dispozicion udhëzuese të qarta për të garantuar konfidencialitetin dhe mbrojtjen e informacionit të shprehur nga fëmijët.

#### ***(5) Hartimi dhe përdorimi i protokolleve të mbrojtjes së fëmijëve dhe procedurës së ruajtjes dhe garantimit të sigurisë së fëmijëve***

Gjatë punës sonë me dhe për fëmijët, duhet të kuptojmë se pjesëmarrja e fëmijëve si një e drejtë dhe parim udhëheqës ka disa fusha aplikimi. Nëse konsultimet, intervistimet apo marrja e opinioneve të fëmijëve kanë elementë që lidhen me mbrojtjen e fëmijëve (fëmijët vijnë nga grupe vulnerabël apo çështja që trajtohet është sensitive dhe lidhet me dhunën dhe abuzimin, apo fëmijët janë përfitues të një shërbimi mbrojtës etj.) mundet që gjatë procesit të dalin në pah e të jetë e nevojshme ruajtja dhe garantimi i mirëqënies së tyre. Për këtë intervistuesi apo lehtësuesi jo vetëm duhet të ketë njohuritë e duhura por duhet të veprojë edhe në bazë të një protokollit apo procedure të përcaktuar mirë. Nëse një referim për një rast dhune apo abuzimi ndodh gjatë procesit, lehtësuesi do duhet të dijë si të veprojë, çfarë duhet të mbajë shënim, kë të njoftojë dhe në çfarë afatësh. Po ashtu një plan për ofrimin e ndihmës ndaj fëmijës që shprehet për dhunën do duhet të planifikohet dhe të jetë në dispozicion në çdo kohë. Nga ana tjetër, të gjithë personat që angazhohen në organizimin dhe lehtësimin e pjesëmarrjes së fëmijëve, duhet t'i përmbahen një kodi sjelljeje të përcaktuar për të mbrojtur fëmijët nga veprime/sjellje të papërshtatshme të stafëve të angazhuar.

#### ***(6) Të kuptohen dhe vlerësohen diferencat në pushtet mes të rriturve dhe fëmijëve***

Në mënyrë që pjesëmarrja të jetë etike dhe vërtetë vullnetare, është e rëndësishme të kuptohet si qëndron niveli i pushtetit mes të rriturve dhe fëmijëve që përfshihen në një konsultim. Vlerësimi i dinamikave mes të rriturve dhe fëmijëve do japë mundësinë për hartimin e një plani menaxhimi të këtyre dinamikave por dhe të minimizimit të rreziqeve që mund të rrjedhin prej tyre duke garantuar të drejtën e çdo fëmije për t'u dëgjuar (Shembull: mund të ndodhë që fëmijët të mos ndihen të lirshëm për të shprehur mendimet e tyre nëse në procese konsultuese janë të pranishëm njerëz me influencë në jetën e tyre, si mësues, drejtorë, prindër etj).

#### ***(7) Shmangia e tokenizmit***

Natyra dhe qëllimi i pjesëmarrjes së fëmijëve do duhet të jetë gjithmonë i qartë dhe të shprehet në mënyrë transparente gjatë procesit të miratimit. Institucionet që angazhohen me fëmijët në procese pjesëmarrëse apo konsultime do duhet të jenë të qarta në lidhje me kufizimet që ata kanë për të ndërmarrë veprime të metejshme në bazë të gjetjeve apo prioriteteve të shprehura nga fëmijët dhe aftësinë e tyre për të advokuar në emër të fëmijëve të tjerë nëse do ish nevoja. Po ashtu, nxjerrja e të dhënave duhet të ndjekë një proces transparent dhe informimi të fëmijëve të pranishëm, përfshirë dhe mundësinë e prodhimit të raporteve në një gjuhë të përshtatshme për fëmijët.

#### ***(8) Garantimi i një qasjeje gjithëpërfshirëse***

Është e rëndësishme që metodat e përdorura gjatë organizimit të proceseve me pjesëmarrje, të maksimizojnë shanset që vajzat dhe djemtë të marrin pjesë njëllor dhe në mënyrë të barabartë, që të bëhen të gjitha përpjekjet e të merren të gjitha masat që fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijë nga minoritetet apo nga grupet e pafavorizuara të përfshihen gjithashtu në mënyrë aktive dhe të plotë.



Respektimi i të drejtës për pjesëmarrje të individëve apo grupeve shoqërore të caktuara duhet sidoqoftë shoqëruar me vlerësimin e potencialit të rreziqeve që mund t'u shkaktohen si rezultat i angazhimit.

## **A është gjithmonë e përshtatshme pjesëmarrja e fëmijëve?**

Disa procese që kërkojnë pjesëmarrjen e fëmijëve mund të mos jenë gjithmonë të përshtatshme për fëmijët për t'u angazhuar (psh: monitorim/ vlerësim, studim, konsultim etj). Për këtë, të rriturit përgjegjës do duhet të bëjnë një analizë të faktëve në lidhje me situatën konkrete. Përgjigjet që marrin pyetjet e listuara më poshtë ndihmojnë personat përgjegjës të kuptojnë nëse pjesëmarrja është e përshtatshme dhe e realizueshme dhe në këtë mënyrë të marrin vendimin e duhur për angazhimin apo jo të fëmijëve.

- *A është studimi/ vlerësimi/ konsultimi me pjesëmarrje vërtetë i nevojshëm?*
- *Përse duhet që fëmijët të marrin pjesë në këtë aktivitet? Nëse fëmijët kanë probleme madhore të varfërisë apo dhunës, sa e rëndësishme do ishte për ta pjesëmarrja në këtë aktivitet?*
- *A ka prioritete të tjera më të rëndësishme? Sigurimi mbijetesës, strehë, veshmbathje...?*
- *Pa e parë pjesëmarrjen si një qëllim në vetvete, konkretisht cilat do ishin përfitimet për fëmijët në këtë rast? Si do arrihej kjo?*
- *Lehtësuesit e procesit/ monitoruesit/ studiuesit, a i kanë aftësitë e duhura për të drejtuar një vlerësim apo studim me pjesëmarrje të fëmijëve?*
- *Pjesëmarrja kërkon kosto materiale dhe kohë, a i kemi burimet e nevojshme? A kemi mjaftueshëm kohë në dispozicion për të organizuar një proces të mirëfilltë e kuptimplotë?*
- *A kemi kontakte direkte me fëmijët?*
- *Fëmijët, a i kanë aftësitë për një pjesëmarrje domethënëse?*
- *Nëse inkurajojmë pjesëmarrjen e fëmijëve në këtë proces, a shkaktojmë konfuzion/ ngarkesë/ shqetësim tek fëmijët?*
- *A do të çënoheshin pozitat apo dinamikat e fëmijëve në familje, shkollë, komunitet, institucione si rezultat i pjesëmarrjes së tyre në këtë proces?*
- *A mundemi ne të ofrojmë mbështetjen e nevojshme për fëmijët dhe të vijojmë me ndjekjen e procesit?*

## V. MBROJTJA E SIGURISË SË FËMIJËVE NË PROCESAT Pjesëmarrëse

Mbrojtja e fëmijës është një ndër principet themelore të **Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës** dhe përbën themelin e punës së të gjithë profesionistëve, insitucioneve apo organizmave që punojnë me dhe për fëmijët. Bazuar dhe në kriteret e përcaktuara në Ligjin Nr. 18/2017 “PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS”, është një detyrim ligjor dhe moral i secilit për të garantuar që proceset ku përfshihen fëmijët të jenë të sigurta, dhe duhet bërë gjithçka nën kontrollin e drejtuesve të këtyre proceseve për t’i mbajtur të sigurtë fëmijët me të cilët ata janë nën kontakt apo me të cilët punojnë. Në situata të caktuara pjesëmarrja e fëmijëve qoftë në nivel konsultimi apo pjesëmarrjeje të drejtuar nga fëmijët mund të përmbajë rreziqë për fëmijët sidomos ata që bëjnë pjesë në grupet vulnerabël/ e marginalizuar.

Për këtë arsye masat për mbrojtjen e fëmijëve janë të domosdoshme për të siguruar procese pjesëmarrjeje të sigurta dhe të ndjeshme ndaj rreziqëve. Këto masa duhet të garantojnë që shëndeti, siguria fizike dhe emocionale, mirëqënia dhe interesi i tyre me i lartë, janë të mbrojtur gjatë gjithë procesit të pjesëmarrjes në çfarëdo niveli qoftë ai. Gjithashtu, ato duhet të garantojnë që masat për mbrojtjen e fëmijës nuk çenojnë autonominë, pavarësinë dhe lirinë e fëmijës.

### Masat që sugjerohen:

- Kur planifikoni një aktivitet me pjesëmarrje të fëmijëve, bëni një vlerësim të rreziqeve të mundshëm që mund t’u kanosen fëmijëve gjatë çdo hapi të procesit (Shih shtojcën nr. 1).
- Bëni një ndarje të qartë të roleve dhe përgjegjësi të të rriturve të përfshirë në proces.
- Informoni fëmijët rreth masave dhe rregullave të mbrojtjes së fëmijëve dhe sigurohuni që ata i kanë kuptuar siç duhet.
- Informoni të rriturit (shoqëruesit e fëmijëve, lehtësuesit e aktivitetit, apo persona të tjerë në kontakt me fëmijët) për rolin dhe përgjegjësitë që ata kanë.
- Sigurohuni që formularët e lejeve nga prindërit, janë firmosur dhe ruajtur përpara së të fillojë aktiviteti.
- Sigurohuni që fëmijët të shoqërohen gjithmonë nga një i rritur dhe sipas rrethanave fëmijët të jenë të pajisur me sigurim shëndetësor.
- Sigurohuni që një i rritur tek i cili fëmijët kanë besim është përcaktuar si pikë kontakti për çështjet e mbrojtjes së fëmijës dhe fëmijët janë vënë në dijeni për këtë.
- Krijoni një sistem të dhënash me të gjitha detajet e pjesëmarrësve (adresa, nr. telefonit i kontaktit, nevojat mjekësore, formularët e lejes nga prindit/ kujdestari ligjor) dhe përcaktoni një të rritur si përgjegjës për ruajtjen dhe administrimin e këtij informacioni.
- Respektoni privatësinë e fëmijës. Raportet e shkruara, fotografitë apo filmimet video dhe audio nuk duhet të zbulojnë identitetin e fëmijëve pa u marrë paraprakisht leja nga prindi dhe vetë fëmija.

- *Pjesëmarrja e fëmijëve është vullnetare dhe gjithësecili fëmijë duhet të ndihet i lirë të largohet dhe të mos jetë pjesë e aktivitetit/ procesit nëse e dëshiron diçka të tillë.*
- *Fëmijët duhet të trajtohen me respekt dhe duhet të njihen si individë me të drejta, pavarësisht moshës.*
- *Sigurohuni që çdo gjë e diskutuar, dakordësuar apo/ edhe e prezantuar gjatë konsultimit apo aktivitetit, përfshirë edhe fotot, filmimet apo regjistrimet audio qëndron konfidenciale dhe mund të bëhen publike vetëm pasi fëmijët të kenë dhënë pëlqimin paraqark për publikimin e tyre.*
- *Të rriturit që shërbejnë si lehtësues në proceset apo në aktivitetet pjesëmarrëse konsultative, duhet të pajisen paraqarkisht me udhëzues që shpjegon qartësisht sesi duhet të sillen dhe veprojnë në raste raportimi nga fëmijët apo dëshmie situatash abuzimi, dhune dhe çdo lloj tjetër situatë sensitive që ka të bëjë me mirëqenien e fëmijëve.*
- *Të rriturit që shërbejnë si lehtësues në proceset apo në aktivitetet pjesëmarrëse konsultative, duhet t'u mundësojnë fëmijëve një atmosferë të hapur besimi reciprok ku ata të mund të diskutojnë çdo problematikë apo shqetësim të ngritur prej tyre.*
- *Të rriturit që shërbejnë si lehtësues në proceset apo në aktivitetet pjesëmarrëse konsultative, duhet të shmangin veprime apo sjellje që mund të lenë hapësirë për abuzime të mundshme. Ata nuk duhet të përdorin fjalor, japin sugjerime apo këshilla që janë të papërshtatshme, ofenduese apo/ edhe abuzive që synojnë të turpërojnë, ofendojnë, diskriminojnë apo përjashtojnë fëmijët.*

## VI. KRITERET E PËRGJITHSHME TË Pjesëmarrjes së fëmijëve

**Pjesëmarrja e fëmijëve është:**

- *Transparente dhe informuese për të gjithë*
- *Llogaridhëse*
- *E sigurtë*
- *Pjesëmarrja është relevante/domethënëse/e përshtatshme*
- *Bazuar në respektin e ndërsjelltë*
- *Vullnetare*
- *Miqësore me fëmijët*
- *Gjithëpërfshirëse*
- *Mbështetet nga të rritur miqësorë dhe të mire informuar*

## **Kriteri #1:**

### **Pjesëmarrja është transparente dhe informuese për të gjithë**

#### **Përshkrimi i kriterit:**

1. Pjesëmarrja duhet të zhvillohet në parametra të përcaktuara dhe të qartësuara paraprakisht për të cilat të gjithë aktorët, të rriturit e përfshirë dhe gjithashtu fëmijët të jenë në dijeni dhe të kenë rënë dakord.
2. Planifikimi i aktivitetit bëhet në një hark kohor në varësi të aktivitetit dhe të intensitetit të tij duke lejuar kohë të mjaftueshme për organizimin e pjesëmarrjes së fëmijëve.
3. Përcaktimi i roleve dhe përgjegjësive të të gjithë aktorëve të përfshirë (fëmijë apo të rritur) realizohet dhe dakordësohet që në fillim të procesit.
4. Fëmijët përfshihen që në fillim të procesit dhe japin mendimin e tyre për ndërtimin dhe përmbajtjen e tij.
5. Fëmijëve iu vihet në dispozicion i gjithë informacioni i nevojshëm që u nevojitet atyre për të dhënë kontribut domethënës. Fëmijët kanë akses- por në këtë rast lihet në dorë të tyre, ndërkohë që vënia në dispozicion nga të rriturit mundëson që ata të kenë realisht informacion.
7. I gjithë dokumentacioni i nevojshëm paraqitet në gjuhën amtare për të gjithë fëmijët.
8. Në rastet kur nevojitet përfaqësim, përzgjedhja e fëmijëve bëhet sipas një procesi transparent, gjithëpërfshirës dhe të dakordësuar me fëmijët.

## **Kriteri #2:**

### **Pjesëmarrja është miqësore me fëmijët**

#### **Përshkrimi i kriterit:**

1. Aktivitetet me fëmijët dhe metodat e përdorura për përfshirjen e tyre ndihmojnë në formimin dhe rritjen e vetbesimit dhe vetvlerësimit tek fëmijët dhe të rinjtë.
2. Aktivitetet ndërtohen dhe zhvillohen në bashkëpunim me fëmijët dhe metodologjia e përfshirjes së tyre i përshtatet moshës, preferencave dhe aftësive të tyre.
3. Burime njerëzore, materiale dhe kohë e mjaftueshme lihet në dispozicion të procesit të pjesëmarrjes.
4. Të rriturit e përfshirë në aktivitete pjesëmarrëse me fëmijët, janë të mirëtrajnuar për të kuptuar vlerën e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe e mbështesin atë.
5. Fëmijët mbështeten me informacion në një gjuhë të kuptueshme për ta dhe aktivitete trajnuese që i ndihmojnë ata të zhvillojnë aftësitë e tyre për të siguruar pjesëmarrje efektive.
6. Fëmijët pyeten gjithmonë mbi informacionin që u nevojitet dhe ky informacion u mundësohet atyre në kohë të mjaftueshme, format miqësor për përdorim nga fëmijët dhe në gjuhën që fëmijët komunikojnë dhe kuptojnë më mirë.
7. Përkthimi mundësohet në çdo aktivitet apo situatë ku fëmijët përballen me një gjuhë tjetër, mosnjohja e të cilës ndikon negativisht në të kuptuarin, komunikimin dhe si rrjedhojë pengon pjesëmarrjen e plotë në diskutime.
8. Të rriturit përdorin gjuhë jo teknike me fëmijët dhe shpjegojnë çdo term apo zhargon teknik që mund të haset gjatë diskutimeve apo në dokumentët e shkruara.

## **Kriteri #3:**

### **Pjesëmarrja është llogaridhënëse**

#### **Përshkrimi i kriterit:**

1. Fëmijët njihen në kohë me impaktin e përfshirjes së tyre dhe rezultatet konkrete të vendimeve të marra bashkarisht me ta dhe hapat e mëtejshëm.
2. Fëmijëve u kërkohet gjithmonë mendim rreth eksperiencës së tyre të pjesëmarrjes duke u fokusuar në sugjerimet për përmirësim.
3. Rezultatet, monitorimet dhe vlerësimet e aktiviteteve, u komunikohen në gjuhë të përshtatshme të gjithë fëmijëve të përfshirë, së bashku me angazhimet për të konsideruar mësimet e nxjerra në punën e ardhshme.
4. Fëmijët duhet të angazhohen në vazhdimësi dhe në mënyrë të qëndrueshme.
5. Fëmijët marrin pjesë/ angazhohen në procese monitorimi dhe vlerësimi ku u mundësohet dhënia e përshtypjeve dhe përfshirja e komenteve në raporte.
6. Fëmijët mbështeten për të vënë në zbatim çështjet e identifikuara gjatë procesit të vlerësimit.

## **Kriteri #4:**

### **Pjesëmarrja është e sigurtë**

#### **Përshkrimi i kriterit:**

1. Nevojat për mbrojtje të fëmijëve identifkohen dhe planifikohen përpara çdo aktiviteti apo procesi konsultues.
2. Mekanizmat e duhur të parashikuar në rregullore/dokumentet ligjore që parashikojnë masat për mbrojtjen e fëmijëve aktivizohen me qëllim parandalimin dhe minimizimin e rreziqeve.
3. Vlerësim i kujdesshëm bëhet në lidhje me rreziqet që lindin si pasojë e lirisë së të shprehurit dhe pjesëmarrjes së fëmijëve në fushata ndërgjegjësimi/advokimi sidomos në rastin e çështjeve sensitive.
4. Vendet, sallat ku zhvillohen mbledhjet dhe aktivitetet me fëmijë janë vende ku fëmijët ndihen të qetë, të sigurtë dhe të mbrojtur. Ata duhet të jenë të përdorshme edhe nga fëmijët me aftësi të kufizuara.
5. Plan masash konkrete bazuar në rreziqet e parashikuara duhet të jetë efektiv dhe të parashikojë në mënyrë të detajuar hapat që duhet të zbatohen për të siguruar mbrojtjen e fëmijës nga rreziqët dhe mbrojtur identitetin e fëmijës.
6. Asnjë informacion i dhënë nga fëmija, fotografi, video apo çdo lloj tjetër të dhënash që i përkasin fëmijës nuk duhet të merren apo publikohen pa lejen/ pëlqimin e fëmijës.
7. Në çdo aktivitet, komunikim, pavarësisht pjesëmarrjes fizike apo jo, fëmija është i mbrojtur nga çdo formë abuzimi, shfrytëzimi, dhune, diskriminimi dhe keqtrajtimi.
8. Pjesëmarrja e fëmijëve nuk i vendos ata në asnjë rast në kushte rreziku apo situata stresuese.
9. Fëmijët dhe të rriturit në vazhdimësi në çdo aktivitet, informohen në lidhje me politikat e mbrojtjes së fëmijëve dhe kodin e etikës përfshirë udhëzime të qarta në lidhje me çfarë duhet të bëjnë apo nuk duhet të bëjnë në raste rreziku.



## **Kriteri #5:**

### **Pjesëmarrja është relevante/ domethënëse/ e përshtatshme**

#### **Përshkrimi i kriterit:**

1. Çështjet e shtjelluara, aktivitetet e planifikuara janë të përshtatshme dhe domethënëse për fëmijët e përfshirë dhe bazohen në njohuritë, aftësitë dhe mundësitë e tyre.
2. Fëmijët përfshihen/ angazhohen në vendosjen e kriterëve për përzgjedhjen dhe përfaqësimin e tyre.
3. Fëmijët duhet të përfshihen/ angazhohen në mënyra të ndryshme në përshtatje me aftësitë dhe interesat e tyre.
4. Angazhimet e tjera të fëmijëve në shtëpi, shkollë etj, duhen respektuar në kohë, përmbajtje dhe eksperiencë.
5. Metodologjitë e punës me fëmijët dhe përfshirjes së tyre duhet konsiderojnë më të mirën e traditave, dijes dhe praktikave të komunitetit.

## **Kriteri #6:**

### **Pjesëmarrja është e bazuar në respekt reciprok**

#### **Përshkrimi i kriterit**

1. Opinionet e të gjithë fëmijëve respektohen dhe konsiderohen gjatë procesit të vendim-marrjes.
2. Ushtrimi i së drejtës së pjesëmarrjes nuk bie ndesh me përmbushjen e angazhimeve të tjera. (p.sh shkollimi)
3. Shëndeti dhe mirëqenia e fëmijës nuk kompromentohen nga ushtrimi i së drejtës për pjesëmarrje.
4. Fëmijët respektohen në çdo kohë dhe situatë, pavarësisht moshës, gjinisë, prejardhjes etnike apo kushteve socio-ekonomike.

## **Kriteri #7:**

### **Pjesëmarrja është vullnetare**

#### **Përshkrimi i kriterit**

1. Pjesëmarrja e fëmijëve është vullnetare dhe ata mund të heqin dorë në çdo moment që e gjykojnë të arsyeshme.
2. Fëmijëve u jepet kohë për të vendosur nëse duan të marrin pjesë apo jo.
3. Fëmijët janë të lirë të heqin dorë nga çdo angazhim në çdo kohë gjatë procesit të pjesëmarrjes.

## **Kriteri #8:**

### **Pjesëmarrja është gjithëpërfshirëse**

#### **Përshkrimi i kriterit:**

1. Të gjithë fëmijët duhet të kenë shanse të barabarta për të ushtruar të drejtën e tyre të pjesëmarrjes pa u diskriminuar për shkak të moshës, gjinisë, aftësive, gjuhës, origjinës, etnisë, prejardhjes gjeografike.
2. Aktivitetet, metodat e përdorura për angazhimin dhe pjesëmarrjen e fëmijëve duhet të jenë lehtësisht të adaptueshme për t'iu përgjigjur grupmoshave të ndryshme, diferencave gjinore, nevojave, aftësive dhe pritshmerivë të grupimeve të ndryshme të fëmijëve.
3. Nuk ngrihen hamendësimet mbi çfarë një grup i caktuar fëmijësh mund apo nuk mund të bëjë.
4. Të rriturit me ndikim në komunitetet e tyre duhet të përfshihen për të fituar mbështetjen e grupeve të marginalizuara.

## **Kriteri #9:**

### **Pjesëmarrja mbështetet nga të rritur miqësore dhe të mirë informuar.**

#### **Përshkrimi i kriterit**

1. Të rriturit që punojnë me fëmijët duhet të kuptojnë dhe të mbështesin pjesëmarrjen e fëmijëve.
2. Të rriturit duhet t'u nënshtrohen trajnimeve specifike rreth praktikave dhe metodologjive pjesëmarrëse, aftësive teknike në komunikim, lehtësim, zgjidhje konfliktesh, diversitet etj, që u nevojiten për të punuar efektivisht me fëmijët.
3. Të rriturit duhet të mbështeten, mbikqyren dhe t'u jepet mundësia të vlerësojnë eksperiencën e tyre në garantimin e pjesëmarrjes së fëmijëve.

## VII. LISTË KONTROLLUESË PËR MBARËVAJTJEN E PROCESIT

### **Transparente dhe informuese për të gjithë**

- ✓ A është objektivi i procesit të pjesëmarrjes mjaftueshëm i qartë dhe i njohur për të gjithë fëmijët e përfshirë?
- ✓ A është materiali i prezantuar tek fëmijët i përgatitur në një gjuhë dhe format lehtësisht të kuptueshëm për ta?
- ✓ A janë informuar fëmijët rreth të drejtës së tyre për liri mendimi dhe pjesëmarrje siç sanksionohet në UNCRC?
- ✓ A janë informuar prindërit/ kujdestarët ligjorë të fëmijëve në lidhje me qëllimin, strukturën dhe impaktin e pritshëm të këtij procesi?
- ✓ A janë diskutuar dhe dakordësuar paraqakisht me fëmijët qëllimet, struktura dhe rezultatet e pritshme?

### **Vullnetare**

- ✓ A iu është dhënë fëmijëve kohë e mjaftueshme për të shqyrtuar mundësinë/ dëshirën për pjesëmarrje?
- ✓ A janë informuar lehtësuesit se ata nuk duhet dhe nuk mund t'i detyrojnë fëmijët të shprehin mendimin e tyre në rast se fëmijët vetë nuk e duan diçka të tillë?
- ✓ A janë informuar fëmijët se pjesëmarrja është vullnetare dhe ata kanë të drejtë të lenë procesin në çdo moment që ata duan.
- ✓ A është përshtatur procesi i pjesëmarrjes me nevojat, ritmin apo edhe angazhimet e tjera të fëmijëve pjesëmarrës?

### **Bazuar në respektin e ndërsjelltë**

- ✓ A janë marrë në konsideratë opinionet e fëmijëve në vendim-marrje?
- ✓ A janë konsultuar fëmijët që në fazën e parë të procesit të konsultimit/ pjesëmarrjes?
- ✓ A është lënë në dispozicion kohë e mjaftueshme për konsultim me fëmijët?
- ✓ A mbështeten nismat e fëmijëve në lidhje me çështjet që ata duan të diskutojnë?
- ✓ A u është dhënë fëmijëve feedback i qartë dhe i kuptueshëm?

### **Relevante/domethënëse/e përshtatshme**

- ✓ A është ndërtuar procesi i pjesëmarrjes për të qenë një proces i vazhdueshëm apo vetëm një aktivitet në një kohë të caktuar?
- ✓ A i përgjigjet procesi nevojave të fëmijëve?

### **Miqësore me fëmijët dhe të rinjtë**

- ✓ A është vendi i mbledhjes miqësor dhe i aksesueshëm për të gjithë fëmijët?
- ✓ A janë planifikuar mjaftueshëm pushime ndërmjet sesioneve në agjendë?

- ✓ A është i gjithë informacioni dhe procesi i pjesëmarrjes/ konsultimit miqësor për fëmijët dhe i përshtatshëm për grupmoshën e përzgjedhur?

### **Gjithëpërfshirëse**

- ✓ A marrin pjesë në proces/ konsultim fëmijë nga prejardhje të ndryshme etnike, socio-ekonomike, gjinore, gjeografike? A janë të përfshirë fëmijët pjesë e grupeve vulnerabël, me aftësi ndryshe, minoritetet, fëmijët në varfëri dhe fëmijët në kontakt me ligjin?
- ✓ A janë marrë masa (mbështetje për udhëtim, përkthim gjuhësor dhe lehtësues me eksperiencë në punën me fëmijët) për sigurimin e mundësive për pjesëmarrje të këtyre grupeve të fëmijëve?

### **Mbështetet nga të rritur miqësorë dhe të mire informuar**

- ✓ A është shpërndarë informacioni i duhur programatik në lidhje me pjesëmarrjen e fëmijëve si princip thelbësor i të drejtave të fëmijëve?
- ✓ A janë shpërndarë materiale që ndihmojnë të rriturit të punojnë me fëmijët dhe të lehtësojnë pjesëmarrjen aktive të tyre?
- ✓ A janë trajnuar të rriturit në lidhje me Konventën e të Drejtave të Fëmijëve dhe principet bazë që përshkojnë atë?

### **E sigurtë**

- ✓ A janë firmosur nga fëmijët, prindërit/ kujdestarët ligjorë/ lejet/ formularet përkatës në lidhje me pjesëmarrjen, fotografimin, regjistrimin audio dhe video, etj?
- ✓ A është përcaktuar personi i kontaktit për mbrojtjen e fëmijëve?
- ✓ A janë informuar fëmijët rreth masave për mbrojtjen e fëmijëve?

### **Llogaridhënëse**

- ✓ A vlerësohet procesi i pjesëmarrjes dhe a janë të përfshirë fëmijët në këtë vlerësim?
- ✓ A u raportohen rezultatet e procesit fëmijëve në një gjuhë miqësore me ta?
- ✓ A janë alokuar mjaftueshëm burime financiare dhe njerëzore në pjesëmarrjen e fëmijëve?

## VIII. LEHTËSIMI I PROCESIT

### **Çfarë cilësish dhe aftësish duhet të ketë një drejtues i mirë:**

- i. Duke marrë në konsideratë gjithë çfarë ky udhëzues parashikon, është tej mase e rëndësishme për personat që drejtojnë një proces konsultimi apo angazhimi të fëmijëve të kenë jo vetëm njohuritë e dhura në fushë, por të kenë edhe një sërë karakteristikash të tjera si:
  - Aftësi shumë të mira lehtësuese, komunikuese dhe të jenë dëgjues të mirë.
  - Të jenë të aftë të krijojnë një marrëdhënie besimi me fëmijët.
  - Të jenë të aftë të ofrojnë mbështetje dhe të ndihmojnë fëmijët në situata sjelljesh të vështira kur janë nën stress.
  - Të jenë të kujdesshëm dhe të kuptojnë komunikimin jo-verbal.
  - Të arrijnë të identifikojnë situatat dhe fëmijët që kanë nevojë për ndihmë më specifike.
- ii. Të njihet mirë situata e fëmijëve që frekuentojnë/ marrin shërbimin.

Në mënyrë që lehtësuesit e rritur të hartojnë një metodologji efektive për realizimin e procesit, duhet të kenë mirë parasysh karakteristikat e grupit me të cilët do të punojnë, moshën dhe kapacitetin e tyre. Është përgjegjësia e tyre të përshtasin metodat që do të përdoren nëse në grup do marrin pjesë fëmijë nga grupe të përjashtuara sociale që paraqesin vështirësi më të mëdha, që mund të kenë vështirësi në të kuptuarin e gjuhës (në rastin e fëmijëve nga pakicat gjuhësore) apo nëse kanë nivel të ulët të të nxënës, apo janë analfabetë. Po ashtu, metoda specifike do të duhet të përdoren në rastin e angazhimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar. Metodatat do duhet të krijojnë balanca në grup përsa i përket dinamikave të pushtetit (disa fëmijë mund të ndihen me “të pushtetshëm” dhe të tjerë më të mënjanuar, avantazhet dhe disavantazhet si mes fëmijëve vetë, po ashtu edhe mes fëmijëve dhe të rriturve. Të rriturit duke u mbështetur dhe në eksperiencën e fituar duhet të jenë krijues, me aftësi përshtatjeje dhe të përdorin kurdoherë metoda të pranueshme kulturalisht dhe të përshtatshme për grupin konkret pa u ndjerë të detyruar t’i përmbahen instruksioneve mbi mënyrat dhe metodat e lehtësimit. Është e rëndësishme që kur punohet me fëmijët të ketë ushtrime zgjimi argëtuese që zhvillojnë komunikimin në grup bashkëbisedimi të jetë i këndshëm dhe me ritëm si edhe gjuha e përdorur të jetë e kuptueshme duke u përshtatur me moshën.

- iii. Të evidentohen rreziqet dhe të hartohet një plan për mitigimin e tyre. Të analizohet dhe zbatohet praktikimi i parimit të “Mos sjelljes së dëmit tek fëmija” (le të kujtojmë parimin e “Interesit më të lartë të fëmijës” që prevalon mbi të gjitha parimet e tjera, edhe mbi atë të pjesëmarrjes).
- iv. Qartësimi i qëllimit të angazhimit të fëmijës: shembuj konkretë mund të jenë në rastet kur merret mendimi në procesin e hartimit të planit individual të mbrojtjes/ndërrhyrjes; marrja e mendimit në procese të divorcit/ vendosjes së familjes kujdestare/ birësuese; marrja e mendimit për cilësinë e shërbimeve të ofruara në qendër/ institucion; konsultimin për planifikim të aktiviteteve të qendrës/ institucionit etj.
- v. Identifikimi/ përzgjedhja i/e personave që do të drejtojnë procesin: personi udhëheqës që do të lehtësojë procesin dhe personi mbështetës që do të asistojë në proces.



## IX. PËRFSHIRJA E FËMIJËVE – PËRQASJE SEKTORIALE

Përveç sektorit të arsimit me futjen e Dispozitave Normative të Ngritjes dhe Funkcionit të Qeverisë së Nxënësve si dhe ngritjes dhe funksionimit të Bordeve të shkollave, asnjë sektor tjetër nuk ka mekanizma konkretë të institucionalizuara që të garantojnë të Drejtën e Fëmijëve për t'u shprehur dhe dëgjuar.

Agjencitë dhe instituconet në kontakt me fëmijët duhet të përfshijnë në rregulloren e brendshme procedurën për ngritjen e grupeve të konsultimit të fëmijëve ku të përcaktohen fushat e aktivitetit (konsultim/marrje opinionit, planifikim; vlerësim; etj); mënyra dhe kriteret e përzgjedhjes së fëmijëve përfaqësues; personat që udhëheqin këto procese; si kryhet dokumentimi dhe raportimi të fëmijët dhe gjithashtu çfarë ka ndodhur me opinionet dhe mendimet e shprehura nga fëmijët.

### • **Shërbime Shoqërore**

Parimi i Pjesëmarrjes së Fëmijëve gjen pasqyrim në standardet e cilësisë së shërbimeve në strukturat shërbim-ofruese sipas tipologjive, por mënyra sesi ndërtohet dhe menaxhohet procesi i pjesëmarrjes nuk specifikohet.

Teorikisht, kjo e drejtë realizohet nga stafi psiko-social i shërbimit. Po ashtu, një nga parimet udhëheqëse të protokollit për menaxhimin e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje është edhe përfshirja e fëmijës në proces duke e informuar dhe gjetur së bashku me të, sistemimin më të mirë në lidhje me situatën që paraqitet. Këtë proces e planifikon, organizon dhe drejton Punonjësi i Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve.

Sidoqoftë, shërbimet e mbrojtjes shoqërore sipas tipologjisë së tyre, duhet të ngrenë me rregullore të brendshme një mekanizëm funksional për realizimin e pjesëmarrjes në mënyre sistematike dhe kuptimplotë.

Gjithmonë bazuar në moshën dhe aftësitë e fëmijës, punonjësit sociale do të duhet të sigurojnë:

- i. *Të përfshijnë fëmijën në çdo hallkë të ofrimit të shërbimit duke e informuar si për situatën ashtu dhe për mundësitë që i ofrohen dhe së bashku të vendoset dhe për mënyrën më të mirë të ofrimit të suportit.*
- ii. *Fëmijët të jenë pjesë e rëndësishme e vlerësimit/ monitorimit të shërbimit duke dhënë opinionet e tyre në lidhje me cilësinë e shërbimeve që marrin dhe opinionet për përmirësime të mundshme. Në këtë kuadër Save the Children në Shqipëri, ka hartuar një instrument për vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të kujdesit shoqëror ndaj fëmijëve nëpërmjet konsultimit me vetë fëmijët përfitues të këtyre shërbimeve. Ky instrument do të shërbejë të gjitha institucioneve me një mandat monitorues dhe inspektues të standardeve të cilësisë së shërbimeve.<sup>1</sup>*

1. Save the Children në Shqipëri, PËRFSHIRJA E FËMIJËVE NË VLERËSIMET E SHËRBIMIT; Bharti Mephani, Tiranë 2017

- iii. Në raste të përfshirjes së grupeve të fëmijëve në situatë vulnerabiliteti të cilët marrin shërbime të mbrojtjes shoqërore në institucione ditore, rezidenciale, struktura komunitare etj, përgatitja për një proces pjesëmarrës duhet të jetë i vëmendshëm dhe shumë i kujdesshëm. Aftësitë komunikuese të të rriturve marrin vlerë kryesore: në situata vështirësish, fëmijët kanë nevojë për mbështetje morale por edhe për ndihmë praktike psh: një fëmijë i mbetur pa kujdes prindëror ka nevojë për një të rritur që të kujdeset për të, që ta këshillojë e ta drejtojë. Fëmija në çfarëdo situatë qoftë (familje me probleme, në kujdes rezidencial, fëmijë në situatë rruge, fëmijë i dhunuar etj) ka nevojë për dikë me të cilin të hapet, të flasë për shqetësimet e tij. Nëse fëmija nuk ka dikë që mund ta dëgjojë dhe ta ndihmojë, atëherë ai do të mbetet i vetëm me shqetësimin e tij dhe do të izolohet. Të flasin me dikë, i ndihmon fëmijët të shkarkojnë stresin, e të çlirohen qoftë nëpërmjet fjalëve/ bashkëbisedimit.

## • **Arsim**

Qeveria e nxënësve është një organizëm i sanksionuar në Ligjin Nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, Sipas nenit 36 të këtij ligji, Qeveria e nxënësve mbron dhe promovon të drejtat e nxënësve dhe ndihmon në mbarëvajtjen e shkollës. Ajo ngrihet dhe funksionon sipas udhëzuesit të ministrit, kryetari i qeverisë së nxënësve në arsimin e mesëm të lartë zgjidhet nga nxënësit me votë të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë, qeveria e nxënësve përzgjedh mësuesin ndihmës. Qeveria e nxënësve, siguron pjesëmarrjen e drejtëpërdrejtë të nxënësve në vendimet që lidhen me mbarëvajtjen e procesit edukativ dhe jetës shkollorë në përgjithësi. Qeveria e nxënësve nëpërmjet përfaqësuesve të saj të zgjedhur është pjesë e komisionit të Etikës dhe Sjelljes në institucionin arsimor, merr pjesë në hartimin e planeve dhe raporteve të shkollës, ftohet të jetë pjesë e mbledhjeve të këshillit të prindërve dhe mësuesve si dhe është pjesë e bordit të shkollës. Ky ligj u njuh detyrën drejtuesve të institucioneve arsimore të lehtësojnë pjesëmarrjen e nxënësve nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në qeverinë e nxënësve në të gjithë organizmat shkollorë të parashikuar në ligj, vendimmarrja e të cilëve ndikon drejtpërdrejtë tek nxënësit.

## • **Shëndetësi**

Nuk ka mekanizma apo parashikime për pjesëmarrjen e fëmijëve. Sidoqoftë angazhimi i fëmijëve do ishte me vlerë sidomos në fushën e shëndetit publik. Fëmijët mund të përfshihen në kërkime, studime (përdorimi i substancave si: alkooli, droga, duhani etj), aksesin në shërbimet parandaluese; rolin dhe performancën e mjekut/ stomatologut në shkollë apo në rastin e promovimit shëndetësor, metodat peer to peer<sup>2</sup>, mund të ishin një vlerë e shtuar për targetimin e moshave 6 – 18 vjeç.

Përsa i përket mekanizmit, ai mund të rregullohet në të njëjtën mënyrë si në rastet e shërbimeve shoqërore. Institucionet e shëndetit publik në këtë rast do duhet të kenë një marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet arsimore apo me organizime të tjera të pavaruara fëmijësh nëse ato ekzistojnë në territor.

Qasja ‘Fëmijë me Fëmijë’, parashikon rolin e fëmijëve me të rritur në promovimin jo vetëm të shëndetit fizik tek më të vegjlit (që nga moshat e hershme), por gjithashtu edhe stimulimin e mirëqenies

---

2. Metodologjite që bazohen në të nxënin aktiv dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet bashkëmoshatareve, nga femija tek femija apo i riu tek i riu.

mendore dhe emocionale. Fëmijët më të rritur duke kuptuar më mirë ndjenjat dhe nevojat e fëmijëve më të vegjël, mund të angazhohen në aktivitete stimuluese (përmes lojës, leximit etj) mund të japin një kontribut të vlefshëm në qetësimin e më të vegjëlve apo mbështetjen e tyre kur ata kalojnë momente të vështira.

### • **Drejtësia për të mitur**

Ky seksion i dedikohet fëmijëve në kontakt me ligjin, pra ata janë subjekt, dëshmitarë apo palë në procese gjyqësore.

Të përfshihesh në një proces gjyqësor, cilido qoftë pozicioni është një situatë që mbart ngarkesë të lartë emocionale, kjo edhe më e vështirë për fëmijët. Sistemi i drejtësisë nuk është i konceptuar për të qenë miqësor, sidoqoftë mund të merren masat e nevojshme për tu krijuar fëmijëve kushtet për tu ndjerë sa më të sigurt dhe të qetë për të bërë të mundur përfshirjen e drejtë të tyre.

Disa nga çështjet kryesore që mund të adresohen për të krijuar një ambient të sigurt dhe miqësor:

- *Përfshirja e profesionistëve të aftë, që tregojnë empati, kuptojnë dhe nuk paragjykojnë. Kështu fëmijët do të ndihen të respektuar, krijojnë një marrëdhënie besimi dhe arrijnë të shprehin më lirshëm mendimet e tyre.*
- *Informacioni para praktik mbi situatën, procesin që pritet, pozicionin/ rolin e tyre si dhe efektet që priten. Ata duhet të njohin dhe kuptojnë të drejtat dhe procedurën në mënyrë që përfshirja e tyre të jetë sa më efektive.*
- *Informacioni të jetë sa më i kuptueshëm për fëmijën dhe të jepet në një mënyrë miqësore.*
- *Përzgjedhja e vendeve ku ndodhin intervistat, duhet të jenë sa më miqësore të mundshme duke reduktuar në një mënyrë nivelin e ankthit.*

### **Për çfarë duhet të konsultohemi me fëmijët në institucionet e kryerjes së dënimit:**

- i. *Klasifikimi, vendosja dhe ndërtimi i programit të rehabilitimit - fëmija duhet të konsultohet për të përcaktuar mënyrën më të përshtatshme të kujdesit social që do t'i rezervohet atij.*
- ii. *Edukim, trajnim profesional dhe punë - Qëllimi i edukimit është ta përgatisë fëmijën për mometin e largimit nga institucioni. Për këtë, modeli më i mirë i trajtimit të fëmijës është modeli përkrahës i cili bazohet tek mundësitë e tij prandaj duhet të bëhet në konsultime me vetë fëmijën.*
- iii. *Koha e lirë - mund të zhvillohen veprimtari rikrijuese të sugjeruara nga vetë fëmijët.*
- iv. *Feja - fëmijët mund të marrin pjesë ose të refuzojnë çdo formë organizimi fetar.*
- v. *Kujdesi mjekësor – konsultimet me fëmijët janë të domosdoshme për të kuptuar gjendjen e tyre fizike dhe mendore.*
- vi. *Kontaktet me komunitetin – fëmijët duhet të pyeten dhe t'u merren parasysh mendimet në kontakte që duhet të vendosin me anëtarë të tjerë të komunitetit jashtë institucionit.*
- vii. *Kontrolli dhe ankesat - Fëmijëve duhet t'u njihet e drejta për të folur në kushte konfidencialiteti me çdonjërin nga ata.*

## • **Pushteti Vendor:**

Këshillat Bashkiakë janë institucione vendim-marrëse në nivel lokal përgjegjëse ndër të tjera për planifikimin e shërbimeve në territorin e tyre. Në këtë kuadër fëmijët si një nga grupet e interesit duhet të konsultohen për të dhënë këndvështrimin e tyre në lidhje me nevojat specifike për shërbime (infrastruktura shkollore, ambiente kulturore apo sportive, etj). Disa Bashki kanë krijuar praktika të konsultimit me qytetarët për çështje të caktuara duke përfshirë dhe fëmijët. Por, si mund të konsolidohet kjo praktikë edhe në përfshirjen e mendimeve të tyre në mënyrën më efektive të mundshme? Për këtë duhet të ndiqen hapat e mëposhtëm:

- *Njoftimi i fëmijëve - Grupi i fëmijëve organizohet për t'u përgatitur për procesin, informohen dhe njihen me planin*
- *Puna në grup mbi çështjen ku kërkohet opinion i fëmijëve (udhëhequr nga lehtësuesi përkatës (psh. mësuesi koordinator i Qeverisë së Nxënësve; lehtësuesi i Qendrës Rinore; drejtuesi i grupit të udhëhequr nga fëmijët; etj)*
- *Njohja dhe thellimi tek çështja në diskutim*
- *Artikulimi i qëndrimit dhe mesazheve advokuese, apo përgatitja e një raporti*
- *Caktimi i përfaqësuesve dhe prezantimi i mendimit në mbledhjen e Këshillit Bashkiak.*

## X. GRUPET E KONSULTIMIT TË FËMIJËVE/ PRAKTIKA TË MIRA

*Për sektorët e sipërpërmendur, ka disa përjasje për të organizuar fëmijët e për të mbledhur informacion. Në vijim prezantohet një organizëm konkret i grupimit të fëmijëve për të lehtësuar konsultimin dhe pjesëmarrjen:*

Në mënyrë që çdo sektor të zbatojë detyrimet që parashikon ligji për garantimin e parimit të pjesëmarrjes së fëmijëve, është e nevojshme që të ngrihet një mekanizëm i brendshëm rregullator, ku të parashikohet çdo hap i procesit për përfshirjen e zërit të fëmijëve në çështje që u takojnë atyre. Ky mekanizëm do duhet të parashikojë sesi do të aksesohet grupi i interesit, në këtë rast i fëmijëve, si do të organizohen ata, si do arrijnë të përfaqësojnë opinionin e një grupi më të madh, kush do ta organizojë dhe administrojë procesin, çfarë metodash dhe çfarë instrumentesh do t'iu duhet të përdorin për të realizuar një konsultim, një planifikim apo një vlerësim/ monitorim situatë me pjesëmarrje:

- i. Mënyra më e mirë dhe pikënisja e procesit do ishte ngritja e një grupimi jo formal fëmijësh që mishëron karakteristikat e paraqitura në seksionin “Si realizohet konsultimi? Cilët fëmijë marrin pjesë?”*
- ii. Sugjerohet që limiti i pjesëmarrësve në grup të jetë nga 6 deri 10 persona, djem dhe vajza. Duhet të kemi parasysh gjithmonë që procesi i përzgjedhjes së fëmijëve do duhet të jetë i mirëmenduar dhe shumë korrekt në mënyrë që të jetë demokratik, gjithëpërfshirës dhe përfaqësues siç kemi parashtruar në seksionet më lart.*
- iii. Si fillim fëmijët do të informohen për llojin e aktivitetit ku kërkohet të japin kontribut (konsultim, planifikim, vlerësim/monitorim) të njihen me qëllimin, mënyren si do ndërtohet procesi, kush e drejton procesin, çfarë pritjet prej tyre, shtrirja kohore dhe si do të përdoren opinionet dhe kontributi i tyre.*
- iv. Fëmijët njoftohen që ata janë të lirë të jenë pjesë, apo të tërhiqen në çdo moment të procesit kur e shohin të nevojshme. Organizatorët duhet të mendojnë edhe për moshën e fëmijëve që do të përfshihen në grupin e konsultimit.*
- v. Nëse fëmijët do të mblidhen për një konsultim plani veprimi vendor, apo kombëtar apo për një nismë ligjore, duhet të vlerësohet edhe kapaciteti i fëmijëve për të kuptuar dhe formuluar mendime në lidhje me çështjet në fjalë, gjë që do të ndikonte edhe grupmoshën e synuar. Nëse fëmijët do të mblidheshin për të marrë opinion apo për të vlerësuar një shërbim që ata vetë përfitojnë, atëherë kjo do të lidhet edhe me tipologjinë e shërbimit dhe grupmoshës që i ofrohet shërbimi.*
- vi. Në rastin e fëmijëve në një proces gjyqësor civil (vendosje në familje kujdestare, birësim apo në raste divorci etj) legjislacioni përkatës ka përcaktuar edhe moshën për marrjen e mendimit (10 vjeç) dhe dhenien e pëlqimit (12 vjeç) dhe kjo bëhet në përputhje me zhvillimin dhe aftësitë e fëmijës ndaj dhe ka përcaktime të rolit dhe funksionit të psikologut në proces.*
- vii. Përcaktimi i grupmoshës duhet të jetë përfaqësues që të përmbledhë një rang të gjerë fëmijësh. Sidoqoftë, sugjerohet që ndarjet në grupe të mos përbëjnë diferenca madhore të grupmoshave sipas karakteristikave të fazave të zhvillimit, ndaj mund të krijohet më shumë se një grup me fëmijë 8-11,*

12-14 dhe 15-18 vjeç. Të gjitha këto çështje do të analizohen në fazën e përgatitjes së procesit pjesëmarrës.

### • **Planifikimi i një konsultimi**

Në çdo rast, Grupi i Konsultimit të Fëmijëve duhet të kalojë në një proces paraprak, përpara se të kalohet në qëllimin final të pjesëmarrjes. Duhet kushtuar kohë dhe vëmendje procesit të njohjes dhe identifikimit/ përkatësisë si pjesë e grupit. Informimi dhe diskutimi paraprak për çështjen në fjalë, duhet të ndodhë në sesione të posaçme, ku pasi të shpjegohet qëllimi dhe procesi, fëmijët pjesëmarrës të kenë një informacion më të thelluar për çështjen në fjalë.

**Shembull:** Nëse do të diskutohet hartmi i planit vendor për fëmijët, grupi duhet të njihet me çfarë është një plan, cilët janë komponentët e tij dhe çdo të thotë secili prej tyre, kush e realizon, çfarë do të thotë (pra çfarë efektësh ka) për fëmijët dhe ku do të konsistonte kontributi i fëmijëve. Në varësi të volumit të informacionit përcaktohen edhe numri i seancave.

Sesionet e takimit	Aktiviteti	Procesi dhe dinamikat e grupit
<b>Sesioni 1</b>	Për çfarë jemi mbledhur (shpjegimi i aktivitetit) Dakordësimi për takimet, metodat që do të përdoren	Krijimi i besimit mes anëtarëve të grupit dhe krijimi i përkatësisë në grup
<b>Sesioni 2</b>	Diskutimi i rregullave të funksionimit të grupit Çështjet që do të diskutohen Çështje të Mbrojtjes së Fëmijëve (Politika për Mbrojtjen e Fëmijëve)	Krijimi i besimit mes anëtarëve të grupit dhe krijimi i përkatësisë në grup
<b>Sesioni 3</b>	Diskutimi i çështjeve në fokus njohja/ informimi mbi çështjen në diskutim	Respekti dhe mirëkuptimi Normalizimi
<b>Sesioni 4</b>	Dhënia e opinionëve mbi çështjen	Produktiviteti

**Shënim:** Shpeshherë procese të konsultimit me fëmijë apo vlerësimi mund të iniciohen nga një institucion qendror apo vendor jo në kontakt të drejtpërdrejtë me fëmijët psh: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale apo Bashkia. Në këtë rast personi i ngarkuar nga institucioni, i cili përmbush kriteret dhe karakteristikat e përshkruara në seksionin 3 të këtij udhëzuesi, vihet në kontakt me shërbime që punojnë me fëmijët (shkolla; qendra shërbimi; qendra rinore; klube fëmijësh etj) dhe koordinojnë së bashku aktivitetin pjesëmarrës (ngritjen dhe formimin e grupit të konsultimit).

Në të gjitha rastet do duhet patur parasysh Ruajtja dhe Garantimi i Sigurisë së Fëmijëve dhe përcaktimi i personit përgjegjës për çështje të ruajtjes së sigurisë së fëmijëve (Shtojca 1- Një model/ përmbledhje i Politikës për Mbrojtjen e Fëmijëve).

## • **Lista e Kontrollit për përcaktimin e Interesit më të lartë të Fëmijës**

Siç është shprehur dhe në fillim të këtij dokumenti, në çdo proces ku përfshihen fëmijët, parimi i Interesit më të lartë të tyre është parimi thelbesor që udhëheq veprimet dhe vendimet e vendimarrësve dhe kujdestarëve. Sidoqoftë është e nevojshme për të qenë të qartë se cilët janë elementët që duhen analizuar dhe të merren parasysh për një vendim-marrje në interes të fëmijës.

Për këtë na ndihmon Komenti i Përgjithshëm i Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve Nr. 14, ku përshkruhen 14 elementë për t'u vlerësuar dhe përcaktuar Interesin më të Lartë të Fëmijës që janë:

1. Opinioni/ këndvështrimi i fëmijës për çështjen në fjalë
2. Identiteti i Fëmijës
3. Ruajtja e ambientit familjar dhe i marrëdhënieve
4. Përkujdesi, mbrojtja dhe siguria e fëmijës
5. Situata e vulnerabilitetit;
6. E drejta e fëmijëve për kujdes shëndetësor;
7. E drejta e fëmijës për edukim.

Komenti i përgjithshëm shpjegon gjithashtu që Interesi më i Lartë i Fëmijës duhet të analizohet dhe përcaktohet për secilin rast në bazë të rrethanave të tij specifike (për çdo fëmijë apo për çdo grup fëmijësh).

Këto rrethana lidhen me karakteristikat individuale apo të grupit në fjalë ku përfshihet edhe konteksti kulturor e social.

### **Bëjini vetes këto pyetje:**

*“Nëse ky do ishte fëmija im, çdo të doja të ndodhte me të?”*

Apo, nëse e keni të vështirë pasi nuk keni fëmijë, mund të pyesni veten:

*“Nëse do isha unë ky fëmijë, çfarë do të doja të ndodhte me mua?”*

Me shumë gjasa përgjigjia e sinqertë e kësaj pyetjeje do përcaktonte dhe interesin më të lartë të fëmijës.

Më poshtë, po prezantojmë praktikën e përfshirjes së fëmijëve në Grupet e Udhëhequra nga Fëmijët “Zëri 16+...”<sup>3</sup> në konsultime të Këshillave Bashkiakë në Durrës, Burrel, Elbasan, Peshkopi. Kjo praktikë mund të përshtatet lehtësisht dhe të aplikohet në çdo bashki të vendit.

- i. Mbledhjet e Këshillit të Bashkisë ndiqen nga fëmijët kur ata kanë një çështje për të trajtuar, ose në komisione të veçanta si ai i arsimit, shëndetësive apo ekonomisë etj. Përzgjedhja e fëmijëve që marrin pjesë në këto takime, bazohet në njohuritë që ata kanë mbi çështjen për diskutim dhe angazhimin*

3. Zëri 16+...“ është grupi i fëmijëve që udhëhiqet nga vetë fëmijët. Grupi e shtrin aktivitetin e vet në katër qytete të Shqipërisë si: Elbasan, Durrës, Dibër dhe Burrel. Misioni i tyre është: Ndërgjegjësimi dhe fuqizimi i fëmijëve lidhur me respektimin e të drejtave të tyre në shkollë, familje dhe komunitet gjithashtu ndikimi i tyre në vendim-marrje për përmirësimin e situatës së të drejtave të fëmijëve në Shqipëri.

rreth saj. Kriter kryesor është njohja e mirë e grupit dhe e problemit që po shtrohet, pse është duke u trajtuar, çfarë kemi bërë ne, cilat janë burimet e informacionit, rruga e ndjekur etj, si edhe rekomandimet për zgjidhjen e çështjes së ngritur prej tyre. Por, gjithashtu në takim përfshihen edhe femijë të rinj me qëllim që përvec se të marrin pjesë në këto takime, të edukohen me ndjenjën e përgjegjësisë dhe kurajon për të biseduar me autoritete.

- ii. Grupi i fëmijëve organizohet për t'u përgatitur për procesin, informohen dhe njihen me planin, diskutojnë përmbajtjen e tij dhe ndërtojnë se bashku mesazhet e tyre advokuese. Ky proces kërkon një angazhim kohor deri në 4 takime të njëpasnjëshme të grupit. Në fund grupi vendos të zgjedhë 2 përfaqësues (sipas kriterëve të përcaktuara, fëmijët përzgjedhin njëri-tjetrin ose përfshihen me iniciativë) dhe së bashku me lehtësuesin e rritur do të jenë pjesë e mbledhjes së Këshillit Bashkiak, ku do të prezantojnë idetë e tyre dhe paraqesin kërkesën.

Që kjo praktikë të jetë e aplikueshme për çdo Bashki, duhet që përfaqësues të Këshillit Bashkiak të krijojnë akses tek opinioni i fëmijëve. Për këtë, krijohen kontakte dhe ndërtohen marrëdhënie me shërbime dhe grupime ekzistuese si: Qendra Rinore, Qendra Shërbimesh për Fëmijë, grupime jo formale fëmijësh. Nëse këto qendra dhe grupime mungojnë mund të angazhohen strukturat e Qeverive të Nxënësve në bazë shkolle.



## SHTOJCA NR. 1 – POLITIKA E MBROJTJES SË FËMIJËVE

### 1.1. Hyrje

Të gjithë kemi përgjegjësinë për të siguruar që fëmijët me të cilët punojmë janë të mbrojtur dhe të sigurtë nga çdo lloj ngacmimi apo dëmi që mund t'u shkaktohet nga persona të tretë.

Ne, dëshirojmë që fëmijët e përfshirë në këtë aktivitet të kënaqen, të shijojnë aktivitetin dhe të jenë të sigurtë.

<b>Udhëzues që na ndihmojnë të mbajmë fëmijët të sigurtë:</b>	<b>Personi i kontaktit për organizuesit</b>	<b>Afati i përmbushjes së detyrës</b>	<b>Statusi i përmbushjes së detyrës</b>
<b>Përpara zhvillimit të aktivitetit:</b>			
Marrja e miratimit të informuar nga prindërit/ kujdestarët për çdo fëmijë pjesëmarrës (ka specifikime dhe detaje të organizimit si lloji i aktivitetit, çfarë pritet të bëjë fëmija, data, orari, të dhëna mbi udhëtimin: si psh të dhëna të mjetit dhe drejtuesit, targa dhe Nr. Kontakti, personi/ personat shoqërues dhe Nr. kontakti, miratim për bërje dhe përdorim fotosh duke specifikuar qëllimin e përdorimit të tyre).	XY	2 ditë përpara aktivitetit	Në proces: është bërë njoftimi dhe pritet miratimi me shkrim.
Vlerësimi i rreziqeve të mundshme gjatë aktivitetit:			Në proces
Ekipi i ndihmës së shpejtë – në marrëveshje me Shërbimin e Shëndetit Publik.			
Konfirmimi i Policisë për mbikqyrjen e aktivitetit gjatë gjithë kohës së zhvillimit.			
Emrat e shoqëruesve të fëmijëve (mësues/prindër etj) që janë caktuar dhe të garantohet se është bërë vlerësimi i figurës së tyre (të besuar, gëzojnë respekt tek fëmijët; janë të komunikueshëm, të përgjegjshëm etj).			
Transporti i fëmijëve në aktivitet kryhet nga: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Furgon/ autobuz i licensuar.</li> <li>2. Mjeti i prenotuar dhe në dispozicion vetëm të grupit të fëmijëve.</li> <li>3. Mjeti ka ndenjset të pajisura me rripat e sigurimit (të cilët duhet të mbahen lidhur gjatë gjithë udhëtimit).</li> <li>4. Fëmijët janë të shoqëruar nga të rriturit gjatë udhëtimit</li> <li>5. Prindërit që duan të shoqërojnë fëmijët janë të mirëpritur (shpenzimet e tyre mbulohen nga ata vetë).</li> </ol>			

Lista përfundimtare e fëmijëve dhe të rriturve shoqërues hartohet dhe konfirmohet 2-3 ditë para zhvillimit të aktivitetit.			
Fëmijët akomodohen në hotelin e caktuar nga organizuesit e aktivitetit . 1. Fëmijët qëndrojnë të grumbulluar në të njëjtin vend. 2. Ndarja bazohet në gjininë e fëmijëve (veç vajzat dhe veç djemtë) 3. Të rriturit shoqërues nuk ndajnë asnjëherë dhomën me fëmijët.			
Shoqëruesit e rritur informohen përpara aktivitetit mbi politikën për ruajtjen dhe sigurinë e fëmijëve nga personat e caktuar për këtë çështje.			
Fëmijët pjesëmarrës informohen mbi çështjet e ruajtjes dhe sigurisë së fëmijëve: 1. Nëse ka një shqetësim në lidhje me një rrezik për fëmijët nga një sjellje e papërshtatshme e të rriturve që punojnë/ janë në kontakt me fëmijët. 2. Ku duhet raportuar shqetësimi.			
Tualetet janë të ndara dhe të shenjuara sipas gjinisë (vajza/ djem)			
<b>Gjatë Aktivitetit</b>			
Siguria e fëmijëve të përfshirë në aktivitet, është e mbikqyruar dhe e garantuar gjatë gjithë aktivitetit.	Gjithë stafi organizues		
Tualetet janë të mbikqyruara gjatë gjithë aktivitetit.			
Skuadra e ndihmës së shpejtë është prezente dhe në gatishmëri gjatë gjithë kohëzgjatjes së aktivitetit.			
Prania e Policisë për mbikqyrjen e ecurisë dhe moslejimin e ndërhyrjeve nga persona të tretë në aktivitet.			
<b>Pas Aktivitetit</b>			
Transporti i fëmijëve në vendbanimet e tyre ndjek hapat si në rastin e transportit gjatë mbërritjes.			
Udhëtimi kryhet gjatë ditës duke evituar udhëtimin në mbrëmje/natën.			

## **1.2 Kujdes! Çdo person pjesëmarrës në aktivitetin me fëmijë duhet të ketë parasysh:**

Sjellje që janë të ndaluara të ndodhin:

- Goditja apo sulmi fizik i fëmijës.
- Përfshirja në aktivitet seksual me këdo nën moshën 18 vjeç, pavarësisht marrëveshjes së pretenduar. (Mosdijenja për moshën nuk përbën mbrojtje).
- Ngritja e marrëdhënieve të tilla me fëmijët që mund të konsiderohen shfrytëzuese apo abuzuese.

- Veprime abuzive apo që mund ta vendosin fëmijën në rrezik abuzimi.
- Përdorimi i shprehjeve, sugjerimeve apo këshillave të papërshtatshme, ofenduese apo abuzive.
- Veprime fizike të papërshtatshme apo të një natyre seksuale provokative.
- Fjetja në një dhomë me fëmijën apo në një shtrat.
- Kryerja e veprimeve personale për fëmijën, të cilat fëmija mund ti bëjë vetë.
- Veprime që turpërojnë, denigrojnë, ofendojnë fëmijën apo çdo lloj forme të abuzimit emocional.
- Diskriminimi i çdo lloj natyre, sjellje/qëndrim i padrejtë, i diferencuar, favorizues të disa fëmijëve përkundrejt të tjerëve.
- Kalimi i kohës më vetë me fëmijë pa praninë dhe larg të tjerëve.
- Vendosija e vetës në situata që mund të rrezikohet për akuza sjelljeje të padenjë.

### 1.3 Çfarë duhet të bëhet në rast se ka një shqetësim për fëmijë që mund të jetë abuzuar.

- Vepro me shpejtësi dhe kërko ndihmë.
- Mbështet dhe respekto fëmijën. Brenda mundësive siguro që fëmija të jetë i sigurtë.
- Raporto ngjarjen tek personi i kontaktit për Ruajtjen dhe Sigurinë e Fëmijëve dhe ndiq procedurën.
- Mbaj çdo informacion konfidencial.

#### **Informacion mbi kontaktet e emergjencës:**

- |                      |         |
|----------------------|---------|
| - Policia            | 126/129 |
| - Zjarrëfikësi       | 128     |
| - Urgjenca mjekësore | 2222235 |
| - Farmaci 24 orëshe  | 2222241 |

### 1.4 Plani i garantimit të ruajtjes dhe sigurisë së fëmijëve

Aktiviteti: Fushatë Ndërgjegjësuese – Maratone

Data: \_\_\_\_\_

Vendi: \_\_\_\_\_

**Numri total i fëmijëve të përfshirë: 65 fëmijë**

#### **Vendbanimi i fëmijëve:**

Tiranë - 33 fëmijë, Gjirokastrë - 16 fëmijë, Korçë - 16 fëmijë

#### **Numri total i të rriturve lehtësues të përfshirë në aktivitet:**

Tiranë – 15 lehtësues, Korçë dhe Gjirokastrë – 10 lehtësues

## **Raporti të rritur/ fëmijë – 1 i rritur/ 3-4 fëmijë<sup>4</sup>**

Gjatë gjithë kohës, përpara, gjatë dhe pas aktivitetit deri në përcjelljen e tyre në vendin e banimit në Gjirokastrë dhe Korçë, 32 fëmijë shoqërohen nga 10 të rritur.

### **Vendi ku zhvillohet aktiviteti:**

Stadiumi Kombëtar “Qemal Stafa”

### **Data dhe ora:**

18 Tetor, Ora: 10.00 – 12.00

### **Personat përgjegjës për sigurinë dhe ruajtjen e fëmijëve: (që ngarkohen për këtë aktivitet)**

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

---

4. Standardi minimal i aplikuar për raportin të rritur/ fëmijë është 1:4

## SHTOJCA NR. 2- FORMAT MARRJE PËLQIMI PËR PJESËMARRJE

### Modeli nr 1

#### Prezantim

- a. *Idetë tuaja janë të rëndësishme... dhe do të na ndihmojnë për të ndihmuar fëmijë të tjerë në të gjithë botën.*
- b. *Ne përfaqësojmë një organizatë/ institucion që punon për të mbështetur fëmijët dhe të rinjtë, për t'u siguruar që ata janë të sigurt, të mbrojtur dhe që marrin përkujdesin e duhur.*
- c. *Ne po kërkojmë pjesëmarrjen tuaj dhe shpresojmë që ajo do të japë një mundesi për ju, që të përfshihen duke ndarë idetë tuaja dhe duke ndihmuar të kuptojmë çfarë është e rëndësishme për ju.*
- d. *Si mund të marrësh pjesë?*
- e. *Përshkrim i procesit ku fëmija pritët të përfshihet*
- f. *Miratimi juaj*

#### Format Miratimi për filmim/ marrje fotosh

Faleminderit që na lejon t'ju filmojmë/ fotofojmë. Ne do ta përdorim këtë filmim dhe/ ose fotot, për publikim e raportit të Analizës së Situatës së Fëmijëve dhe të Rinjve si ti.

Fotot dhe filmimet e tua, mund të shfaqen në këtë publikim, në internet, në revista, gazeta apo materiale të tjera të printuara, në mediat sociale: si Facebook apo Tëitër, në television, në publicitet apo në mënyra të tjera. Njerëz nga e gjithë bota mund të shohin fotot apo të dëgjojnë komentet tuaja në video, e po ashtu edhe miq apo të afërm.

Kontributi juaj do të ruhet në një vend të sigurt dhe mund dhe të ri-përdoret nga organizata/ institucioni në materialet tona sensibilizuese edhe në të ardhmen, jo për më shumë se 5 vjet.

Nëse bini dakord me këto kushte dhe kuptoni sa thuhet me poshtë, atëhere ju lutem na jepni të dhenat tuaja dhe firmosni këtë format.

Për çfarë bini dakord (detaje ligjore): \_\_\_\_\_

Ju i jepni organizatës/ institucionit të drejtën për të rregjistruar pa pagesë kontributin tuaj zanor, filmim, fotografi dhe çdo rregjistrim tjetër elektronik dhe të përdorë kontributin tuaj në çdo media (ekzistuese apo që do ngrihen në të ardhmen) në të gjithë botën dhe pa pagese të asnjë lloji.

Organizata/ institucioni mund të editojë, përshtasë apo përkthejë kontributin tuaj, dhe ju konfirmoni që ia përcillni të gjitha "të drejtat morale" për t'u përdorur siç shpjegohet më lartë.

Organizata/ institucioni mund ta përdorë kontributin tuaj sërish në çdo moment në të ardhmen deri në 5 vjet.

**Nëse ju firmosni në emër të një fëmijë, atëherë ju:**

1. Deklaroni që jeni babai/ nëna/ kujdestari/ kujdestari ligjor (ju lutem fshini opsionet sipas rastit), i fëmijës të cilit i jepet emri më poshtë dhe është nën moshën 18 vjeç, dhe se ju jeni mbi moshën 18 vjeç. Nëse jo, ju lutem kërkojini një të afermi/kujdestari ligjor mbi moshën 18 vjeç, të firmosë në emrin tuaj.
2. Konfirmoni se ju e keni lexuar këtë marrëveshje, se jeni të kënaqur, se është në interes të fëmijës të cilit i jepet emri më poshtë dhe se ju lejoni fëmijën duke nënshkruar këtë marrëveshje.
3. Brenda interesit tuaj në marrëveshje në emër të fëmijës tuaj, ju i jepni dhe i konfirmoni organizatës/ institucionit të gjitha të drejtat, dakordësinë e dhënë nga fëmija dhe bini dakord që ju mbetëni përgjegjës për fëmijën gjatë gjithë kohës.

**Ky seksion duhet mbushur nga një i rritur mbi moshën 18 vjeç.**

**Shënim:** Nëse prindi është nën moshën 18 vjeç, ju lutem kërkonin një kujdestar ligjor mbi moshën 18 vjeç të firmosë. Psh: gjyshi/ gjyshja.

Ju lutemi mbushni këtë format me Shkronja Shtypi.

Unë po mbush këtë format për veten (mosha 18 vjeç ose mbi 18 vjeç), apo në emër të Fëmijës/ Fëmijëve (unë jam prindi apo kujdestari ligjor), emri i plotë i të rriturit, emri i plotë i fëmijës.

**Muaji/ Data/ Viti** i lindjes të kontribuesit: \_\_\_\_\_

**Email:** \_\_\_\_\_

**Telefon:** \_\_\_\_\_

**Adresa:** \_\_\_\_\_

**Firma apo shenja e gishtit e fëmijës/ të fëmijëve:**

**Firma apo shenja e gishtit e të rriturit:**

**A dëshironi që të përdorim emrin tuaj të vërtetë?** Po Jo

Ne do të ndryshojmë emrin tuaj nëse mendojmë se është më e mira për sigurinë tuaj.

Miratimi që ju po jepni mund të ndryshojë apo të tërhiqet në çdo moment duke kontaktuar me:

**Emri:** \_\_\_\_\_

**Email:** \_\_\_\_\_

**Telefon:** \_\_\_\_\_

Ju lutem, kini parasysh që nuk mund të tërhiqen foto apo imazhe që janë të publikuara tashmë.

I gjithë informacioni do të sigurohet në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave.

## Modeli nr 2

Unë (prindi) \_\_\_\_\_ me nr. kartë identiteti \_\_\_\_\_ jap pëlqimin për vajzën/ djalin tim \_\_\_\_\_, lindur më \_\_\_\_\_, për të udhëtuar në \_\_\_\_\_, nga **dt** \_\_\_\_\_, **ora** \_\_\_\_\_, për të marrë pjesë në **aktivitetin e organizuar nga** \_\_\_\_\_, në shoqërinë e zj. \_\_\_\_\_ me nr. kartë identiteti/ pasaporte \_\_\_\_\_.

Jam informuar nga zj. \_\_\_\_\_ dhe jam dakort për çështjet që do të diskutohen.

Unë zj. \_\_\_\_\_, me nr. kartë identiteti/ pasaporte \_\_\_\_\_, e autorizoj të jetë përgjegjës për vajzën/ djalin tim gjatë këtij takimi.

Në veçanti e autorizoj/ më tej \_\_\_\_\_, të marrë vendime në rastet kur ka nevojë emergjente për trajtim mjekësor.

Unë pohoj se procedurat për sigurimin shëndetësor të vajzës/djalit tim, janë bërë pranë agjencisë së sigurimit \_\_\_\_\_, në konsultim me delegacionin ku bën pjesë vajza/djali im/ynë.

Unë kuptoj se organizata \_\_\_\_\_ nuk mban asnjë përgjegjësi për vajzën/ djalin tonë \_\_\_\_\_ për ndonjë dëm apo humbje që mund t'i ndodhë fëmijës tim/tonë si pasojë e pjesëmarrjes së saj/tij në këtë aktivitet.

Unë pohoj se kam autoritet të plotë të jap pëlqimin mbi përmbajtjen e këtij dokumenti:

**Emri i pjesëmarrësit:** \_\_\_\_\_

**Emri i prindit ose kujdestarit:** \_\_\_\_\_

**Firma e prindit kujdestar:** \_\_\_\_\_

**Data:** \_\_\_\_\_

**Njohur dhe pranuar nga i rrituri shoqërues**

**Njohur dhe pranuar nga:** \_\_\_\_\_

**Firma e të rriturit shoqërues:** \_\_\_\_\_

## SHTOJCA NR. 3 - MODEL PLANIFIKIMI

1	<b>Aktivitet zbavitës</b>	<p>1.Prezantimi/njohja me projektin</p> <p>2.Nxitje e ndërveprimit</p>	<p>Ushtrime energjizuese</p> <p>Prezantim në gjuhë të përshtatshme dhe përdorim mjetesh vizuale projektit</p> <p>Topa djegësi</p> <p>Aktivitet muzikor</p>	Data/Muaji/Viti
2	<b>Krijimi i grupit të konsultimit</b>	<p>1. Kuptimi i dinamikave të grupit dhe karakteristikave individuale të anëtarëve</p> <p>2. Nxitja e bashkëveprimit dhe bashkëpunimit dhe ideja e përkatësisë së grupit</p> <p>3.Kuptimi i qëllimit dhe objektivave të grupit në projekt</p>	<p>Ushtrim energjizues</p> <p>Prezantimi përmes vizatimit të njeriut (vendosja e tipareve dhe karakteristikave nga çdo anëtar i grupit)</p> <p>Përsëritje e qëllimit të projektit në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme</p> <p>Rrahje mendimesh në grup (brainstorming) dhe identifikim rolesh</p> <p>Lojë përmblylëse sugjeruar nga fëmijët</p>	Data/Muaji/Viti
3	<b>Pjesëmarrja e fëmijëve</b>	<p>1. Fëmijët brendësojnë konceptin e pjesëmarrjes dhe punës së përbashkët si grup.</p> <p>2. Nxitja e qartësisë të roleve, bashkëpunimit dhe vendim-marrjes brenda grupit nëpërmjet aktiviteteve krijuese.</p>	<p>Ushtrime energjizuese</p> <p>Identifikimi i elementëve të përbashkët të grupit përmes diskutimit.</p> <p>Përforcimi i qëllimit të grupit:</p> <p>Luajtja e roleve- Ndarja e roleve, përgjegjësi dhe udhëheqja e grupit – fëmijët e ndarë në 2 grupe u jepet një detyrë të cilën do e realizojnë. Vetë fëmijët do ndajnë detyrat dhe përformojnë</p> <p>Përmbledhje e zhvillimit të ditës nga vetë fëmijët.</p> <p>Lehtësuesi nxit diskutimin drejt objektivit.</p> <p>Lojë përmblylëse.</p>	Data/Muaji/Viti



## SHTOJCA NR. 4- MODEL USHTRIME ENERGJIZUESE

### Kush je ti?

Shpërndani letra dhe kërkoni që secili person të shkruajë ose të nxjerrë një përshkrim të shkurtër të vetës. Pastaj ktheni të gjitha letrat me fytyrë poshtë merrni një nga një duke u përpjekur të kuptoni se kujt i përket përshkrimi. Ju mund ta bëni këtë vetë, ose t'ja jepni njerit nga pjesëmarrësit.

### Loja e hedhjes së topit

Ky është një ushtrim zgjimi veçanërisht kur prezantohet një material që kërkon përqëndrim. Bëni që të gjithë të ngrihen dhe të formojnë një rreth. Hidhni një top për një person dhe pyeteni se cili ishte koncepti më i rëndësishëm që mësoi. Pastaj ky person ia hedh topin dikujt tjetër dhe ai person shpjegon se cili ishte koncepti më i rëndësishëm për të. Vazhdoni ushtrimin deri sa të gjithë të kenë kapur topin të paktën një herë.

### Në ishull

Vendosini studentët në grupe prej pesë vetash dhe u thoni atyre se janë të bllokuar në një ishull të shkretë. Shpjegoni se ata duhet të zgjedhin pesë sende nga gjërat e tyre personale për t'i ndihmuar ata të mbijetojnë dhe secili anëtar i grupit të tyre duhet të kontribuojë një gjë. Jepini rreth dhjetë minuta për të gërmuar nëpër çantat e tyre të librit, portofolat ose xhepat për të zgjedhur artikujt e nevojshëm. Pastaj, secili grup të qëndrojë dhe të shpjegojë se çfarë kanë zgjedhur dhe se si çdo objekt është thelbësor për mbijetesën e tyre.

### Karamelet

Blini karamele të vogla me ngjyra të ndryshme. Për secilën ngjyrë zgjidhni një kategori. Psh e kuqja përfaqëson familjen, ngjyra e gjelbër shoqërinë, e verdha hobi. Vendosni sa më shumë karamele në shportë dhe pa i treguar asgjë pjesëmarrësve jepini të marrin sa karamele të duan. Në fund, secili duhet të thotë aq fakte për secilën kategori sa karamele ka marrë (psh 5 karamele të kuqe- 5 fakte për familjen, 3 karamele të gjelbra- 3 fakte për shoqërinë etj).

E njejta lojë mund të bëhet edhe me toptha të vegjël letrash me ngjyra por pjesëmarrësit nuk do të marrin aq shumë në sasi.

### E vërtetë dhe e gabuar

Ndajini pjesëmarrësit me nga dy. Në secilin nga çiftet, njëri duhet të thotë 3 fakte për veten. Nga këto dy janë të vërteta dhe një është genjështër. Personi tjetër duhet të gjejë se cili fakt është i gabuar.

### Uniku

Pjesëmarrësve u thuhet që duhet të tregojmë sa më shumë gjëra të veçanta që kemi ose bejmë. I lëmë të mendojnë 2-3 min pastaj ngrihet një prej tyre. Ai përmend një nga një faktet e tij. Psh kam dy mace. Nëse askush nuk thotë që edhe unë kam dy mace, atëherë ai vazhdon me faktin

e dytë derisa të dalë dikush tjetër që e ka atë karakteristikë. Nëse del dikush atëherë personi ulet dhe ai që e hodhi poshtë fillon flet për vete, derisa të rrëzohet nga dikush tjetër. Për secilin mbahen shënime faktet që nuk janë rrëzuar. Personi që ka numër më të madh karakteristikash të veçanta është më uniku i grupit. Nxitini pjesëmarrësit të fillojnë me: unë jam i vetmi që kam... Psh dy lidhëse të ndryshme këpucësh...une jam i vetmi që kam vëllezër binjakë etj.

## **Bashko kartat**

Lehtësuesi zgjedh një numër shprehjesh të njohura dhe shkruan gjysmën e shprehjes në një letër dhe gjysmën në një tjetër..psh gëzuar –në një copë dhe ditëlindjen në një tjetër. Numri i kartave duhet të përputhet me numrin e pjesëmarrësve. Vendosini në një shportë të gjitha letrat dhe secili zgjedh një dhe secili pjesëmarrës gjen anëtarin tjetër të grupit që ka gjysmën tjetër të shprehjes.

## **Gjej me gjeste**

Ndajini pjesëmarrësit me grupe me nga 5 veta. Secilit grup vendosini një emer për ta bërë më argëtuese. Grupi i zgjedh një profesion dhe e shkruan në një letër dhe nuk ja tregon asnjë grupi tjetër. Këtë duhet ta gjejë grupi i dytë dhe për këtë zgjidhet një vullnetar nga ky grup (të cilit i tregohet profesioni) dhe do t'ia shpjegojë grupit të tij vetëm me gjeste. Nëse e gjen fiton 1 pikë. Pastaj grupi i 2 gjen një profesion për grupin 3 (zgjidhet një vullnetar nga grupi 3, i tregohet profesioni dhe ai ia shpjegon grupit vetëm me gjeste). Grupi 3 zgjedh një profesion për grupin 4. Grupi 4 zgjedh një profesion për grupin 5 dhe grupi 5 zgjedh një profesion për grupin 1. Në vend të profesionit mund të përdoren edhe sende, kafshë etj.

## BIBLIOGRAFIA

- i. Konventa e të Drejtave të Fëmijëve
- ii. Ligjin Nr.18/2017, për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
- iii. COMMITTEE ON THE RIGHTS OF THE CHILD – General Comment n.12
- iv. A Toolkit for Monitoring and Evaluating CHILDREN'S Participation, The Save the Children Fund 2014
- v. Empowering Children to Improve Services in School, Save the Children 2016
- vi. Përcaktimi i Interesit më të Lartë të Fëmijës, Save the Children Albania & International Child Development Initiatives (ICDI).
- vii. Politika e Ruajtjes dhe Mbrojtjes së Fëmijëve – Save the Children International
- viii. Manual Trajnimi për Profesionistët që Punojnë me Fëmijët në Sistemin Penitenciar – Save the Children 2012



**Save the Children**  
100 YEARS

Rruga: Mihal Popi, Ndërtesa 7, ish Pallatet 1 Maji, (Vila Lami);  
PO Box 8185, Tiranë - Shqipëri; Tel: +355 4 2261840/ 4 2261929  
E-mail: [info.albania@savethechildren.org](mailto:info.albania@savethechildren.org)  
[https:// albania.savethechildren.net](https://albania.savethechildren.net)

 [Savethechildrenal](#)  [SaveChildrenAlb](#)